



**APLIKIMI PËR TARIFA TË SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES PËR NIVEL TENSIONI SI
DHE PËR ÇMIMIN E SHËRBIMIT TË
FURNIZIMIT UNIVERSAL 2018**

OSHEE sh.a.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023
Tiranë

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	4
1.1	Vështrim i Përgjithshëm.....	4
1.2	Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura	5
1.3	Përlllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni.....	7
1.4	Indeksi i çmimit të konsumatorit.....	8
1.5	Kursi i Këmbimit Valutor	8
1.6	Aktivite në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë	9
II.	PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI	39
III.	SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE	54
3.1	Shpenzime për blerjen e energjisë për Shërbimin e Furnizimit Universal.....	54
3.2	Shpenzime për blerjen e energjisë për Mbulimin e Humbjeve në Shpërndarje	55
IV.	PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)	55
4.1	Përmbledhje për shpenzimet operative	55
4.2	Shpenzime materiale dhe konsumi.....	57
4.3	Shpenzime për personelin	57
4.4	Shpenzimet për Mirëmbajtje	57
4.5	Penalitete dhe Gjoha	60
4.6	Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing.....	60
4.7	Shpenzime për Qera	60
4.8	Shërbime Postare dhe Komunikimi	60
4.9	Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit.....	61
4.10	Shpenzime Ligjore	61
4.11	Konsulencë dhe Auditim.....	61
4.12	Shpenzime të tjera	61
V.	ASETET BAZË TË RREGULLUARA	61
5.1	Investimet (CAPEX).....	62
5.2	Rivlerësimi i Aseteve.....	63
5.3	Amortizimi.....	63
5.4	Kapitali i punës	66
5.5	Përlllogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara	66
VI.	PËRLLLOGARITJA E NORMËS SË INTERESIT TË BORXHIT	67
VII.	PESHA MESATARE E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT (WACC)	68
VIII.	TË ARDHURAT E KËRKUARA PËR SHPËRNDARËSIN E ENERGJISË	69
8.1	Shpenzimet Operative të Operatorit të Shpërndarjes	71
8.2	Të ardhura nga Lidhjet e Reja dhe Energjia Reaktive	71

IX.	E ARDHURA E KËRKUAR PËR FURNIZUESIN UNIVERSAL.....	71
9.1	Shpenzimet operacionale	71
9.2	Kosto e Transmetimit.....	71
9.3	Marzhi i fitimit.....	71
9.4	Kompensimi për Borxhin e Keq	71
9.5	Përlllogaritja e tarifës për Shërbimin e Furnizuesit Universal	72
X.	PROPOZIM PËR TARIFË MESATARE TË SHITJES NGA OSHEE.....	72
XI.	TARIFA E MIRËMBAJTJES NË ZERO KWH DHE TË TJERA.....	73
XII.	PËRLLLOGARITJA E TARIFËS PËR NIVEL TENSIONI.....	73
12.1	Përlllogaritja e shpenzimeve operative	74
12.2	Kosto e humbjeve.....	74
12.3	Vlera e Aseteve Bazë të Rregulluara dhe Përlllogaritja e WACC	74
12.4	E ardhura e kërkuar për nivel tensioni dhe tarifa	75
	STRUKTURA ORGANIZTIVE E OSHEE	77

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e kërkesës për çmimin e shitjes për klientët tariforë dhe tarifat e shërbimit të shpërndarjes për nivel tensioni bazohet në ligjin e ri “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015, “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” si dhe metodologjive respektive të aprovuara nga ERE për çmimet dhe tarifat.

Periodha prej ndryshimeve të fundit në çmime dhe tarifa të energjisë elektrike 2015 - 2017 ka qënë një periudhë shumë e suksesshme në përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë e cila bëri të mundur që nga një shoqëri me humbje të vazhdueshme OSHEE të jetë një shoqëri që siguron të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet operative dhe me fitimet e veta të mund të mbulojë nevojat për investime. Për tu theksuar se investimet e kryera gjatë kësaj periudhe kanë qënë më të medhatë dhe më intensivët e kryera ndonjëherë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Viti 2017 një vit në kushte të thatësirës së tejzgjatur po shoqërohet me prodhim shumë të ulët të energjisë elektrike nga hidrocentralet vendas (KESH dhe private) gjë që ka sjellë pasojat të rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike për shkak të blerjes në tregun e lirë nga me çmim importi në vend të blerjes me çmim të rregulluar nga KESH. Kosto e energjisë së blerë për vitin 2017 pritet të jetë rreth 14 miliard lekë më e madhe se sa ajo e planifikuar duke krijuar një pritshmëri negative në rezultatin financiar të vitit 2017 për OSHEE.

Pavarësisht nga rezultatet në përmirësim të dukshëm gjendja ekonomike e OSHEE (vazhdim i CEZ Shpërndarje) vazhdon të jetë e vështirë. Kështu gjendja në kapitalin e vet megjithëse e përmirësuar ndjeshëm pritet të jetë akoma negative rreth -31 miliard Lekë nga – 56miliard Lekë që ishte ajo në fund të vitit 2015.

1.1.1 Statusi Ligjor i Shoqërisë

Në dallim me periudhat e mëparshme kur ndryshimet e shpeshta në statusin ligjor të shoqërisë që nga krijimi i OSSH në vitin 2007 u lidhën me privatizimin dhe kalimit të 74% aksioneve në pronësi të CEZ a.s. duke e kthyer atë në CEZ Shpërndarje dhe më pas me heqjen e licencës, kalimit të shoqërisë në administrim të përkohshëm nga ERE si dhe kalimit të 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar në fund të vitit 2014, ndryshimet e pritëshme në fund të këtij viti lidhen me nevojën e hapjes së tregut të energjisë elektrike në zbatim të programit të qeverisë dhe direktivave të Komunitetit Europian.

Në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 shoqëria është duke përfunduar procesin e ndarjes administrative dhe menaxheriale të aktiviteteve të saj në plotësim

të kërkesave të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” për ndarjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Këto ndryshime do të sjellin sigurisht edhe ndryshime në statusin ligjor të shoqërisë që sipas kërkesës së ligjit duke filluar nga 01.01.2018.

Ndarja e shoqërisë, përkundrejt vazhdimin të punës për përmirësimin e treguesve ekonomiko – financiare dhe menaxheriale, bazuar në aktivitetet e licensuara, është një proces që po zhvillohet nën këshillimin e konsulencës dhe eksperiencës më të mirë vendase dhe të huaj dhe nën vëzhgimin dhe ndjekjen hap pas hapi në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Qeverisë Shqiptare.

1.1.2 Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe Tregun Energjistik

Zbatimi në praktikë i ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 është duke u shoqëruar me plotësim të kuadrit ligjor sipas parashikimit ku më të rëndësishme gjatë vitit 2017 janë një varg vendimesh të ndërmarra nga ERE për ndryshime në rregulloret në mbështetje dhe zbatim të ligjit dhe modelit të tregut.

Në zbatim të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” prej datës 1 Korrik 2016 OSHEE vazhdon të kryejë aktivitetin e Furnizuesit Universal si dhe rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të licensuar nga ERE.

Përditësimi i Planit të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike që Qeveria Shqiptare miratoi me vendim të Këshillit të Ministrave nr.171 date 25.02.2015, në përputhje me arritjet e periudhës tashmë 3 vjeçare është bërë një domosdoshmëri për t’u përdorur si një nxitje në zbatim të detyrave, ku fokusi kryesor do të vazhdojë të jetë përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike dhe rritja e normës së arkëtimit.

1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Operatorit të Shpërndarjes për vitin 2018 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Përlllogaritja e tarifës në zbatim të ligjeve në fuqi ka marrë parasysh gjendjen e vështirë financiare që po kalon shoqëria. Në përlllogaritjen e të Ardhurës së Kërkuar janë llogaritur edhe humbjet e si pasojë e mosrealizimit të furnizimit nga KESH gjatë vitit 2017, për shkak të thatësisë së zgjatur e cila u shoqërua me mosrealizim të prodhimit.
- ii. Çmimet për Shërbimit për Furnizuesin Universal dhe OST me të cilat KESH, HEC private dhe OST i shesin energji dhe transmetim OSHEE janë supozuar në 0.75 Lekë/Kwh për shërbimin e transmetimit nga OST dhe 1.5 Lekë/Kwh për energjinë e blerë nga KESH dhe 8.5 Lekë/Kwh nga HEC private për shërbimin e furnizuesit universal.

- iii. Çmimi i energjisë për mbulimin e humbjeve bazohet në parashikimin sipas monitorimit të tregut 2018 dhe që mund të ndryshojë duke u llogaritur si kompensim në vitet e ardhshme të përllogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë.
- iv. Përllogaritja e kërkesës për energji është bazuar gjithashtu në strukturën aktuale dhe parashikimin për vitin në vazhdim por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.
- v. Zhvillimet pozitive të ekonomisë Shqiptare janë marrë parasysh në mosllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjionime të mundshme për efekt të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të shpenzimeve.

Sasia e energjisë së injektuar në sistem për vitin 2018 parashikohet të jetë 6,320 GWH. Sasia e energjisë së shitur parashikohet të jetë 4,803 GWH dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë 1,517 GWH duke parashikuar që niveli i humbjeve të jetë 24%.

Zbatimi i planit të investimeve sipas planit afatgjatë të aprovuar ka sjellë rezultatet e para në uljen e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klienteve. Megjithatë ndikimi është pjesor dhe efektet e më të mëdha në uljen e humbjeve në rrjet sipas planit të hartuar do të kenë ndikim të plotë në performancën financiare të shoqërisë, pasi investimet të jenë shtrirë në përmirësim të pjesës më të madhe të rrjetit. Investimet janë mbështetur dhe do të vazhdojnë të mbështeten kryesisht në burime të brendëshme të shoqërisë (fitimi vjetor i realizuar) si edhe në financimin sipas kredisë së Bankës Botërore. Investimet e parashikuara të kapitalizohen për vitin 2018 janë 12.4 miliard Lekë nga të cilat rreth 2 miliard Lekë nga kredia e Bankës Botërore.

Menaxhmenti i shoqërisë i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve megjithatë është ndeshur me nevojën e rritjes të disa prej tyre nga viti në vit për të rritur performancën duke ushtruar një kontroll më të madh mbi asetet në rrjet dhe përdorimin e tyre në uljen e humbjeve. Në këtë këndvështrim ka një rritje të planit të shpenzimeve operative për vitin në vazhdim 2018 në krahasim me shpenzimet e pritëshme 2017 që lidhen kryesisht me shpenzime të mirëmbajtjes. Kostot e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penalitete të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat pavarësisht metodologjisë do të duhet të pranohen si shpenzime operative të paktën pjesërisht.

Borxhi i keq bazuar në legjislacionin fiskal dhe metodologjisë së tarifave miratuar nga ERE është llogaritur duke mesatarizuar të dhënat e pritshme nga arkëtimi i detyrimeve korente për vitin 2018 sipas studimit të kryer në vitin.

Nga përlllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura në vitin 2018 kap shifrën e rreth 24.8 miliard Lekë për Operatorin e Shpërndarjes, 29.5 miliard Lekë për Shërbimin e Furnizuesit Universal ose 54.3 miliard Lekë gjithsej për OSHEE.

1.3 Përlllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni

Përlllogaritja e tarifës së shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni buron si nevojë e hapjes së tregut në plotësim të kërkesave të ligjit për energjinë si dhe vendimeve të ERE. Duhet theksuar se metodologjia për llogaritjen e tarifës së shpërndarjes përcakton detyrimin e përlllogaritjes së tarifës në nivel tensioni por nuk detajon qartësisht mënyrën e llogaritjes. OSHEE ka akoma e të ndarë aktivitetin e shpërndarjes dhe shitjes dhe nuk ka akoma sistem të ndarë të evidentimit të treguesve financiarë. Treguesit që mund të përdoren janë tregues të konsoliduar, prandaj edhe llogaritja e tarifës në nivel tensioni bazohet kryesisht në koeficientë të gjetur të alokimit të shpenzimeve dhe jo në matjen e tyre të drejtpërdrejtë si më poshtë:

- i. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë megjithë investimet e viteve të fundit është akoma shumë i vjetëruar dhe si i tillë është gati e pamundur të përcaktohen qartë kostot oportune të investimeve të nevojshme për sjelljen e tij në parametra të transmetimit cilësor, prandaj përlllogaritja e kostos së transmetimit për nivel tensioni mund të përmbajë në çdo kohë koeficientë të përafrit vlera e të cilëve, mund të jetë e papranueshme metodologjikisht.
- ii. Vetë rrjeti i shpërndarjes së energjisë si pasojë e mungesës së vazhdueshme të investimeve dhe ndërhyrjeve të shpeshta në kushtet e emergjencave është shumë i paqartë qoftë për ndarjen sipas peshës specifike të përdorimit të tij nga paisjet sipas nivelit të tensionit ashtu edhe në përcaktimin e humbjeve për çdo nivel tensioni.
- iii. Sistemi i informacionit (marrjes së të dhënave) për kostot e drejtpërdrejta dhe ato që do të duhet të alokohen në programin financiar SAP nuk është ndërtuar i tillë që të detajojë në mënyrë të qartë këto informacione. Nuk ka akoma ndarje organizative ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Klientëve Fundorë. Për t'u ridetajuar do të duhet akoma kohë dhe përgatitje e posaçme.
- iv. Përlllogaritja e përgatitur më poshtë është mbështetur në Kërkesën për të Ardhura dhe Çmimin e importit të energjisë për mbulimin e kostos së humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike.
- v. Të dhënat që zotërojmë janë të pamjaftueshme për të përlllogaritur vlerën e saktë të Aseteve Bazë të Rregulluara (RAB) për nivel tensioni, prandaj për këtë si edhe për Peshën Mesatare të Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) janë përdorur koeficientë

shpërndarjeje (alokimi) të cilët mundësojnë përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Shpërndarjes në nivel tensioni.

- vi. Alokimi sipas koeficientëve të llogaritur mbi bazë të energjisë së shitur për nivel tensioni dhe niveli i humbjeve të njohura për çdo nivel tensioni, kanë qenë baza për shpërndarjen e shpenzimeve operative, shpenzimeve për humbjet e energjisë elektrike në rrjet dhe vlerës së Aseteve Bazë të Rregulluara si bazë për llogaritjen e të ardhurave për mbulimin e kostos së kapitalit.

Nga përlllogaritjet në zbatim të metodologjisë dhe koeficientëve të shpërndarjes (alokimit) rezultojnë se tarifa për tensionin 35 kV duhet të jetë 2.36 Lekë/kë, për tensionin 20 – 6 kV 3.81 Lekë /kwh dhe për tensionin e ulët 5.51 Lekë/kwh. Megjithatë në rast se raporti i shitjes në bazë tensioni ndryshon, ndryshon edhe baza e shpërndarjes (alokimit) dhe përlllogaritjet duhet të ndryshojnë tërësisht.

1.4 Indeksi i çmimit të konsumatorit


Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2018 tenton të jetë rreth 4.5%.



Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshmërinë e treguesve ekonomikë të Shqipërisë në përlllogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

1.5 Kursi i Këmbimit Valutor

Sipas të dhënave të mëposhtme të marra nga faqja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë 2017 si në grafikun më poshtë dhe tendencës për vitin 2018, kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1EURO= 134 Lekë.



1.6 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë

1.6.1 Treguesit Kryesorë të krahasuar të OSHEE gjatë vitit 2017 (e pritshëm)

Treguesit kryesorë të performancës së OSHEE (të pritshëm) gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016 paraqiten në tabelën si më poshtë:

000/Leke	Pershkrimi	2015	2016	Parashikim 2017	Diferenca 2017 - 2016	%
Te ardhurat	Të ardhura nga Shitja e energjisë	49,765,384	51,267,345	53,546,667	↑ 2,279,321	104%
	Te ardhur nga kamatevonesat	3,946,147	1,677,087	1,115,777	↓ (561,311)	67%
	Te ardhura nga Shpërndarja (Lidhje të reja)	645,104	540,865	654,852	↑ 113,987	121%
	Te tjera	188,131	207,033	193,601	↓ (13,432)	94%
	Gjithsej	54,544,767	53,692,330	55,510,896	↑ 1,818,566	103%
Shpenzimet	Shpenzime Energji dhe Transmetim	30,382,726	25,665,476	38,987,874	↓ 13,322,398	152%
	Shpenzime Operative	7,323,295	12,094,938	11,978,149	↑ (116,789)	99%
	Provizione	(793,199)	(8,942,259)	1,803,354	↓ 10,745,613	-20%
	EBITDA	17,631,946	24,874,175	2,741,520	↓ (22,132,656)	
	Amortizimi	2,079,534	2,678,027	2,400,000	↑ (278,027)	90%
	Shpenzime Financiare	1,337,347	839,890	169,854	↑ (670,036)	20%
	Tatim Fitimi	2,770,167	2,636,434	730,405	↑ (1,906,030)	28%
Gjithsej	43,099,870	34,972,506	56,069,636	↓ 21,097,130	160%	
REZULTATI I AKTIVITETIT		11,444,897	18,719,824	(588,740)	↓ (19,278,564)	
	Te ardhura te Jashtezakoneshme	4,048,302	115	-		
REZULTATI I PERIUDHES		15,493,200	18,719,939	(588,740)	↓ (19,278,679)	

ENERGJI (MWH)

Energji e Blere	6,494,866	6,297,756	6,472,419	174,662
Energji e Shitur	4,459,444	4,534,384	4,789,590	255,205
Humbje %	31.34%	28.00%	26.00%	↑ -3.00%

Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të OSHEE gjatë vitit 2017 janë si mëposhtë:

- *Rezultati financiar në vazhdim të rezultateve të arritura gjatë periudhës 2015 -2016:* Megjithë kushtet e thatësirës së zgjatur e cila rriti ndjeshëm kostot e blejes së energjisë, viti 2017 pritet të rezultojë me një humbje minimale prej 559 milion Lekë, performanca

e lartë në përmirësimin e treguesve të tjerë financiarë bëri të mundur që humbja e pritëshme të jetë minimale dhe të ruhet ecuria pozitive e periudhës së mëparshme 2 vjeçare 2015 - 2016.

- *Rritje e shpenzimeve për energjinë blerë:* Gjatë 2017 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan 52 % ose 13.3 miliard Lekë më shumë se 2016. Si rezultat i thatësirës së zgjatur prodhimi dhe furnizimi me energji nga KESH me çmim të rregulluar 1.45 Lekë/Kwh u ul ndjeshëm duke detyruar shoqërinë të blejë energji në tregun e importit i cili rriti gjithashtu ndjeshëm çmimin e energjisë në një mesatare prej rreth 9.07 Lekë/Kwh në krahasim me 6.4 Lekë/Kwh që u parashikua në buxhetin e vitit 2017. Kosto e energjisë së blerë për tariforët për shkak të mosfurnizimit nga KESH pritet të jetë 3.88 Lekë nga 3 Lekë të planifikuar me një efekt prej rreth 4.2 miliard Lekë më shumë.
- *Rritje e të Ardhurave nga Energjia:* Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë pritet të rezultojnë 4% më të larta ose 2.3 miliard Lekë më shumë, kushtet e thatësirës dhe verës së nxehtë rritën ndjeshëm përdorimin e energjisë elektrike.
- *Ulja e të ardhurave nga kamatëvonesat:* Masat e marra në aksionin kundër lidhjeve të paligjshme dhe në përmirësimin e arkëtimeve kanë përmirësuar ndjeshëm marrëdhënien e OSHEE me klientët duke rritur ndjeshëm arkëtimet. Rritja e pagesave në afat si dhe politikatat e ristrukturimit të detyrimeve kanë sjellë uljen e të ardhurave nga kamatëvonesat. Të ardhurat nga kamatëvonesat janë ulur 33% në krahasim me vitin 2016 ose 561 milion Lekë më pak.
- Shpenzimet operative për 2017 pritet të jenë 1% më pak se sa ato të vitit 2016 dhe 11% më pak se ato të buxhetuara si pasojë e menaxhimit të kujdesshëm dhe kursimit të vazhdueshëm.
- Arkëtimet pritet të jenë sa 97% e vlerës së faturuar e cila është 4% më e lartë se parashikimi në buxhet si dhe në Planin e Rimëkëmbjes prej 93%.
- Ulja e ndjeshme e shpenzimeve financiare lidhet kryesisht me ndryshime në normat e këmbimit për kreditë e trashëguara në monedha të ndryshme.
- OSHEE gjatë 2017 pagoi brënda afateve këstin e rradhës ndaj CEZ që në total ishin në vlerën e 21 milion Euro.
- OSHEE ka paguar 100% faturat korente ndaj KESH, OST dhe Posta Shqiptare.

1.6.2 Paraqitja e aktivitetit të furnizimit me pakicë të energjisë për periudhën deri në Shtator 2017

1. Treguesit mbi numrin e klientëve të shërbyer dhe marrëdhënia kontraktuale

Numri i klientëve aktivë në faturim të OSHEE-s në 9 Mujorin e 2017 arriti në 1.2 milion, rreth 1.3% më i lartë se numri i abonentëve aktiv në fund të vitit 2016.

Kjo rritje vërehet në kategorinë familjar, në linjë me projeksionet e rritjes së popullsisë e përdorur në parashikimin e kërkesës për energji, po ashtu kjo rritje vërehet dhe në kategorinë privat, buxhetorë dhe jo-buxhetorë.

Numri i Klientëve

Muaj/Viti	Njësia	2014	2015	2016	2017
Janar	Nr	1,162,331	1,186,032	1,214,025	1,190,927
Shkurt	Nr	1,163,336	1,187,207	1,217,567	1,192,419
Mars	Nr	1,166,215	1,193,539	1,220,030	1,194,121
Prill	Nr	1,168,478	1,197,064	1,222,624	1,197,093
Maj	Nr	1,171,117	1,199,598	1,216,087	1,197,867
Qershor	Nr	1,172,694	1,199,408	1,215,169	1,200,646
Korrik	Nr	1,174,112	1,201,739	1,179,541	1,201,742
Gusht	Nr	1,176,089	1,205,229	1,181,271	1,202,510
Shtator	Nr	1,177,530	1,207,977	1,182,314	1,205,220
Tetor	Nr	1,179,652	1,209,316	1,185,930	
Nëntor	Nr	1,181,877	1,209,949	1,188,217	
Dhjetor	Nr	1,184,668	1,212,128	1,189,266	

Peshën më të lartë e mbartin abonentët familjarë në masën 87%, duke vijuar me trendin e viteve pararendëse.

Klientët Sipas kategorisë

Kategoria	V 2013	V 2014	V 2015	V 2016	9M 2017
Buxhetor	9,276	9,399	9,558	8,763	8,930
Jo buxhetor	2,167	2,181	2,290	3,129	3,135
Privat	143,546	148,075	152,805	148,381	151,216
Familjar	1,005,786	1,025,013	1,047,475	1,028,993	1,041,939
SHUMA	1,160,775	1,184,668	1,212,128	1,189,266	1,205,220

Klientët e matur në TM dhe TU tregohet në tabelën si më poshtë:

Klientët sipas Pikës së Matjes

Lloji Tensioni matjes	V 2013	V 2014	V 2015	V 2016	9M 2017
Tension i Mesëm 35Kv	75	77	84	85	85

Tension i Mesëm 35Kv Matje TU	13	13			
Tension i Mesëm 20/10/6 kv	252	262	308	369	405
Tension i Mesëm 20/10/6 kv Matje TU	5,531	5,783	9,025	5,568	5,667
Tension i Ulët Jo familjar	149,118	153,520	155,236	154,250	157,123
Tension i Ulët Blloku Familjar	1,005,786	1,025,013	1,047,475	1,028,994	1,041,940
Total	1,160,775	1,184,668	1,212,128	1,189,266	1,205,220

Klientët e faturuar me matës janë rritur me rreth 5% në periudhën deri në 30/09/2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, dhe kjo rrijte vërehet në të gjitha kategoritë.

Gjatë periudhës që u mbyll më 09/2017, OSHEE ka instaluar një total prej rreth 21 mijë matës nga të cilët rreth 80% janë instaluar te klientët e rinj, duke plotësuar tërësisht kërkesat për lidhje të reja me matje. OSHEE ka realizuar rreth 17 mijë lidhje të reja ku peshën më të lartë e mbartin zonat e shërbimit Tiranë (44% e totalit), Durrës (13% e totalit) dhe Shkodër (9% e totalit).

Lidhjet e reja dhe Matësa të Instaluar gjatë periudhës 09/2017

Muaj/Viti	Njësia	Lidhje të reja me matës	Lidhje të reja	Ndryshimet e matëseve	Matësa të instaluar
Janar	Nr	1,832	1,832	490	2,322
Shkurt	Nr	1,825	1,825	405	2,230
Mars	Nr	1,715	1,715	494	2,209
Prill	Nr	2,098	2,098	910	3,008
Maj	Nr	2,082	2,082	675	2,757
Qershor	Nr	1,945	1,945	248	2,193
Korrik	Nr	2,123	2,123	557	2,680
Gusht	Nr	1,271	1,271	241	1,512
Shtator	Nr	2,164	2,164	232	2,396
Total	Nr	17,055	17,055	4,252	21,307

Sa më lart, janë reflektuar përpjekjet e planeve të punës së OSHEE'së për kthimin në ligjshmëri të veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike, veprime të ndërmarra në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm.

Gjatë këtyre veprimtarive, OSHEE gjatë periudhës 09/2017 ka realizuar rreth 376 mijë kontrole, rreth 195 mijë ndërprerje të energjisë elektrike dhe rreth 60 marrje masash për abuzuesit nga kallëzimet në polici deri në ndalim punonjësish të OSHEE.

Kontrolle gjatë periudhës 09/2017

Muaj	Njësia	Kontrolle	Ndërprerje energjie	% e Ndërprerjeve
Janar	Nr	47,407	25,270	53.30%
Shkurt	Nr	44,369	22,941	51.71%
Mars	Nr	45,066	24,165	53.62%
Prill	Nr	38,075	19,432	51.04%
Maj	Nr	37,694	18,686	49.57%
Qershor	Nr	21,477	10,095	47.00%
Korrik	Nr	47,332	26,283	55.53%
Gusht	Nr	43,331	21,765	50.23%
Shtator	Nr	51,666	26,250	50.81%
Total	Nr	376,417	194,887	51.77%

Statusi i Verifikimit	Njësia	Total 9M 2017
Kallëzim në Polici	Nr	47
Kallëzim në Prokurori	Nr	1
Ndalim nga Policia	Nr	8
Ndalim punonjës OSHEE	Nr	3
Total	Nr	59

2. Treguesit mbi sasitë e furnizuara me pakicë të energjisë elektrike

Sasitë e faturuara / furnizuara

Periudha që u mbyll më 09/2017 u karakterizua nga rritje të sasisë së faturuar ndaj klientëve në masën 3.6% ose rreth 123 Gwh më shumë duke arritur në 3,510 Gwh 2017 kundrejt 3,387 Gwh në po të njëjtën periudhë të 2016. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e:

- Rritjes së kontrolleve në terren për reduktimin e abuzimit me energjinë.
- Kapjen e konsumeve nga klientët.
- Rritjen e kontrolleve të brendshme me qëllim realizimin në kohë të leximeve dhe mënyrën e duhur të tyre nga stafi i zonave të shërbimit.
- Efekti i investimeve në TM/TU.
 - përmirësimin e sistemit të shpërndarjes nën-transmetim për të përmirësuar rehabilitimin e situatës
 - investime në rrjetin e tensionit të mesëm (6-20 kV) që përfshijnë linjat kabllore TM dhe kabina TM/ TU të shpërndarjes, si dhe sistemin e matjes në kabina.

Vëllimi i shitjeve të furnizuara

Vlera e shitjeve të furnizuara të energjisë elektrike në fund 9M 2017 arriti në vlerën 48.1 miliard Lekë (me TVSH). Ky tregues paraqet një rritje në masën 2.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ose 1.2 mld lekë më shumë ; respektivisht 48.1 miliard në fund të 09/17 kundrejt 46,8 miliard në fund të 9M 2016.

Vëllimet e Shitjes në Lek 2013-9M 2017 (përfshirë TVSH)

Muaj/Viti	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017	9M 2017 vs 9M 2016
Janar	000 Lek	4,968,493	4,897,049	5,544,749	5,976,720	6,376,888	6.7%
Shkurt	000 Lek	4,312,055	4,620,685	5,587,202	5,435,148	5,408,731	-0.5%
Mars	000 Lek	4,405,202	4,640,886	5,583,498	5,499,691	5,313,266	-3.4%
Prill	000 Lek	4,000,214	4,535,475	4,949,506	4,818,072	5,029,178	4.4%
Maj	000 Lek	3,643,502	4,186,685	4,519,197	4,824,942	4,842,300	0.4%
Qershor	000 Lek	3,518,254	4,023,370	4,689,340	4,906,746	4,830,720	-1.5%
Korrik	000 Lek	3,671,771	4,095,207	5,248,457	5,284,554	5,570,025	5.4%
Gusht	000 Lek	4,150,093	4,297,338	5,239,562	5,269,209	5,770,763	9.5%
Shtator	000 Lek	3,786,334	4,063,664	4,832,632	4,869,616	4,971,115	2.1%
Tetor	000 Lek	3,378,732	4,278,654	4,681,287	4,842,310	-	-
Nëntor	000 Lek	3,641,034	4,501,743	4,987,835	5,250,049	-	-
Dhjetor	000 Lek	4,464,227	4,980,937	5,864,295	6,420,912	-	-
Total	000 Lek	47,939,911	53,121,693	61,727,561	63,397,970	48,112,986	+2.6%

Plani i veprimeve të ndërrmarra nga OSHEE gjatë 9 Mujorit të 2017 arriti nivelin e humbjeve në masën 26.76% . Sipas bilancit energjetik të OSHEE për 9 M 2017, ka një përmirësim të dukshëm të humbjeve të energjisë. Muaji Shtator 2017, ka shënuar humbjet më të ulta në historinë e OSHEE duke shkuar në 19.79%.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë 09/2016, kemi një reduktim të humbjeve në masën 0.8%, (26,8% në fund të 9M 2017 ndaj 27,6% në fund të 9M 2016) ;

Krahasuar me periudhën 09/2015, rezulton një rënie e konsiderueshme në masën 4.4%

(26,8% në fund të 9M 2017 ndaj 31,1% në fund të 9M 2015)

Krahasuar me periudhën 09/2014, rezulton një rënie e konsiderueshme në masën 11.9%

(26,8% në fund të 9M 2017 ndaj 38.7% në fund të 9M 2014)


OSHEE vazhdon me plane të ndryshme veprimesh për përmirësimin e treguesve të shitjes me qëllim përmbushjen e objektivave të kompanisë. Këtu përmendim:

- Verifikimi sistemim matjeje.

- Sistemimi i kabinave dhe boxeve.
- Plane pune për kapjen e konsumeve në kategoritë privat.
- Kontrollë të kategorive të evidentuara gjatë procesit të leximit.
- Rritjen e kontrolleve në terren për reduktimin e abuzimeve në rrjet.
- Rritjen e kontrolleve të brëndshme me qëllim faturimin sa më korrekt të konsumatorit.
- Ndërgjegjësimin e konsumatorit për rëndësinë e mos shpërdorimit të Energjisë Elektrike .
- Investimeve në rrjet etj.

Energjia e Blerë gjatë 9M 2017, ka pësuar një rritje të konsiderueshme në masën 2.3 % më shumë se e njëjta periudhë kohore e një viti më parë . Kjo rritje për blerje të energjisë ka ardhur si rezultat i ndryshimit të kushteve klimaterike.

Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e faturimit të energjisë për periudhën 9 mujore Janar – Shtator 2013-2017:



Bilanci Energjetik 9M 2013-2017

3. Treguesit e arkëtimit për detyrimet e lindura gjatë vitit 2017

Periudha 9M 2017, u karakterizua nga një trend rritës i arkëtimit total, në masën 5.2% më shumë ose 2.3 mld lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, gjë e cila ka rrjedhur si kombinim i alternimit të kushteve të pagesës së akt-marrëveshjeve të detyrimeve të

prapambetura si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të kategorive të konsumatorëve për nevojën e pagesës në kohë të detyrimeve dhe faturave brënda afateve.

Viti 2015 , është karakterizuar nga një “boom” arkëtimeve, si rezultat i fillimit të aksioneve kundër vjedhjes së energjisë dhe masave të marra ndaj debitorëve.

Vlera e arkëtimeve mesatare mujore gjatë vitit 2017, shkon në vlerën 5.3 mld lekë. Arkëtimet nga këstet e akt-marrëveshjeve përbëjnë rreth 5.2% të arkëtimeve total gjatë vitit 2017.

Arkëtimet totale përfaqësojnë arkëtimet për :

- Arkëtimet për faturat e vitit 2017.
- Arkëtimet për detyrime për faturat e viteve pararendëse.
- Arkëtimet nga kamatë vonesat.
- Arkëtimet nga këstet e akt-marrëveshjeve.

Arkëtimet Totale Mujore për 2013-9M 2017

Muajt/Viti	Njesi	2013	2014	2015	2016	2017
Janar	000 lek	2,678,829	3,898,715	6,237,313	5,500,506	5,670,000
Shkurt	000 lek	3,203,142	3,803,400	7,361,546	5,369,530	5,601,988
Mars	000 lek	3,670,407	4,078,872	6,217,910	5,359,217	5,831,491
Prill	000 lek	3,604,305	4,011,620	5,120,272	5,105,759	5,038,018
Maj	000 lek	3,176,144	3,722,527	4,923,611	4,920,953	5,328,851
Qershor	000 lek	2,549,362	3,364,736	4,610,278	4,577,557	4,464,007
Korrik	000 lek	3,223,521	3,497,972	4,884,468	4,741,724	5,132,726
Gusht	000 lek	3,306,363	3,428,280	5,123,593	5,196,623	5,526,253
Shtator	000 lek	3,352,020	4,562,783	5,247,969	4,974,418	5,534,745
9 Mujori	000 lek	28,764,094	34,368,904	49,726,960	45,746,287	48,128,079
Tetor	000 lek	3,212,186	4,098,478	5,101,905	4,814,976	
Nëntor	000 lek	2,979,109	4,368,117	4,570,444	4,477,630	
Dhjetor	000 lek	3,623,452	6,362,897	5,236,407	5,178,311	
Total	000 lek	38,578,841	49,198,395	64,635,717	60,217,204	48,128,079

OSHEE për qëllime të matjes së performancës, llogarit efektivitetin e aktivitetit të arkëtimeve bazuar në treguesin e Normës së arkëtimet total e cila përlllogaritet si raport i : Arkëtimeve Total mujore ndaj faturimit të muajit pararendës.

Kjo normë arkëtimi në fund të 9M 2017, shkon në masën 99% ndaj 95.5% në fund të 9M 2016 dhe 107.3% në fund të 9M 2015, ku dhe performanca e arkëtimeve ka qënë më e lartë si rezultat i fillimit të aksioneve dhe hedhjes së skemave të reja të akt-marrëveshjeve.

Gjatë vitit 2017, rritja e ndjeshme e arkëtimeve krahasuar me 9M 2016, ka ardhur si rezultat i ndërgjegjësimit të kategorisë familjarë dhe privat në pagesa si dhe rritjes së arkëtimit të faturave brënda 0-90 ditëve.

Norma e arkëtimit 0-90 ditë të faturave korrente gjatë 9M të vitit 2017 arriti në 90% kundrejt 86% në fund të 9M 2016 dhe 83.5% në fund të 9M 2015.

Ky përmirësim i ndjeshëm i arkëtimit të faturave brënda 0-90 ditëve reflektohet në 2 kategoritë kryesore Familjar dhe Privat, ndërkaq kategoritë buxhetorë/jo buxhetorë vazhdojnë ende në performancën jo të mirë të pagesave.

Norma e Arkëtimit për Faturë deri në 90 ditë

Viti 2015

Segmenti	Njës.	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2015
Buxhetor	%	56%	80%	80%	86%	91%	84%	90%	72%	124%	95%	82%	93%	84%
Familjarë	%	79%	80%	90%	86%	85%	89%	91%	88%	89%	91%	85%	95%	87%
Jo- Buxh	%	38%	47%	47%	23%	68%	41%	42%	20%	31%	27%	34%	28%	36%
Privat	%	85%	84%	88%	83%	89%	97%	93%	90%	88%	100%	90%	99%	91%
Total	%	77%	79%	86%	80%	86%	89%	88%	83%	86%	90%	83%	91%	85%

Viti 2016

Segmenti	Njës.	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2016
Buxhetor	%	62%	86%	92%	100%	101%	95%	89%	85%	75%	84%	73%	82%	85%
Familjarë	%	84%	83%	92%	87%	95%	89%	92%	92%	89%	93%	91%	95%	90%
Jo- Buxh	%	26%	26%	35%	22%	30%	27%	26%	18%	18%	17%	16%	23%	23%
Privat	%	90%	89%	96%	90%	99%	92%	91%	97%	94%	99%	90%	94%	94%
Total	%	81%	82%	90%	85%	92%	86%	87%	88%	85%	89%	83%	89%	86%

Viti 2017

Segmenti	Njës.	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2017
Buxhetor	%	73%	70%	117%	83%	89%	88%	89%	78%	80%				84%
Familjarë	%	88%	86%	104%	94%	102%	93%	104%	98%	96%				95%
Jo- Buxh	%	36%	33%	73%	56%	37%	31%	25%	49%	42%				42%
Privat	%	90%	93%	99%	91%	99%	89%	102%	94%	91%				94%
Total	%	84%	83%	101%	89%	94%	86%	96%	91%	89%				90%

4. Cilësia e portofolit të debitorëve dhe veprimet e ndërmarra për reduktimin e borxhit të klientëve

Në fund të vitit 2014 OSHEE trashëgoi një portofol detyrimesh të papaguara nga klientët që kanë origjinën që prej viti 2007.

Vlera totale e detyrimeve të mbartura përbëhet nga detyrimi për fatura (principal) dhe kamatëvonesa për detyrimet e papaguara që llogaritet në masën 0.1% në ditë deri në një maksimale prej 100% të detyrimit të papaguar.

Në fund të 2014 vlera e detyrimeve të mbartura për fatura 2007-2014, ishte 67 mld lekë, dhe në fund të 9M 2017 ky detyrim shkon në vlerën 49.3 mld lekë, me një reduktim të borxhit në vlerën 18 mld ose 27.3%.

Në fund të 2015 vlera e detyrimeve të mbartura për fatura 2015 ishte 8.1 mld lekë, dhe në fund të 9M 2017 ky detyrim shkon në vlerën 5.9 mld lekë , me një reduktim të borxhit 2015 në vlerën 2 mld ose 26.6%.

Detyrimet e prapambetura deri 30/09/2017

Fatura 2007-2014

2007-2014	Fund 2014	Fund 2015	Fund 2016	Fund 9-M 2017
Principal	67,848,538,049	54,482,691,132	51,175,005,991	49,329,564,821
Kamatë	55,997,731,885	45,576,900,598	40,494,044,548	34,561,997,627
Total	123,846,269,933	100,059,591,729	91,669,050,539	83,891,562,447

Fatura 2015

Fatura 2015	Fund 2015	Fund 2016	Fund 9-M 2017
Principal	8,174,927,474	6,191,190,999	5,997,948,602
Kamatë	949,752,984	2,935,838,897	4,227,090,743
Total	9,124,680,458	9,127,029,896	10,225,039,346

Fatura 2016

Fatura 2016	Fund 2016	Fund 9-M 2017
Principal	7,275,127,851	5,868,205,406
Kamatë	974,200,818	2,386,885,390
Total	8,249,328,669	8,255,090,797

5. Treguesit mbi Produktet e ri-pagesës

Deri më 30 Shtator 2017, janë nënshkruar 394,134 AKM, nga të cilat 372,753 nga debitorë familjar dhe 21,381 Jo-familjar. Vlera e detyrimit në akt-marrëveshje shkon në vlerën 45 mld lekë. Vlera e reduktuar e kamatë vonësës deri në fund të muajit Shtator është 20 mld lekë.

Nr. AKM të lidhura

Kategoria	Tipi i Produktit	Njësia	2014	2015	2016	9M 2017	Total
Familjarë	Familjarë 1000	Nr.	3,119	21,134			24,253
	Familjarë 1200	Nr.	130	2,465	36,925	1,694	41,214
	Familjarë 2800	Nr.		1	3,503	5,104	8,608
	Me Këste	Nr.	5,087	2,295	987		8,369
	Me Këste 2500	Nr.	3,819	15,730			19,549
	Me Këste dhe Reduktim Kamate	Nr.		12,236	75		12,311
	Reduktim Kamate	Nr.	45,550	193,948	12,630	6,321	258,449
	Familjarë Total		Nr.	57,705	247,809	54,120	13,119
Jo-Familjarë	Biznes i Vogël 100	Nr.		90	486	5	581
	Biznes i Vogël 1000	Nr.		15	229		244
	Me Këste	Nr.	3,414	7,798	478	9	11,699
	Me Këste dhe Reduktim Kamate	Nr.			1,211	935	2,146
	Privat Riskedulim	Nr.			129	188	317
	Reduktim Kamate	Nr.		2,665	2,573	1,156	6,394
Jo-Familjarë Total		Nr.	3,414	10,568	5,106	2,293	21,381
Total		Nr.	61,119	258,377	59,226	15,412	394,134

Vlera e Detyrimit në AKM

Kategoria	Tipi i Produktit	Njësia	2014	2015	2016	9M 2017	Total
Familjarë 1000	Familjarë 1000	000 lek	823,158	4,919,942	-	-	5,743,100
Familjarë 1200	Familjarë 1200	000 lek	50,914	564,478	7,356,272	632,806	8,604,470
Familjarë 2800	Familjarë 2800	000 lek	-	365	1,150,311	1,708,046	2,858,723
	Me Këste	000 lek	301,587	345,731	124,644	-	771,962
	Me Këste 2500	000 lek	1,266,556	4,661,628	-	-	5,928,184
	Me Këste dhe Reduktim Kamate	000 lek	-	395,495	3,118	-	398,614
	Reduktim Kamate	000 lek	4,542,017	11,735,777	387,405	172,444	16,837,642
Familjarë Total		000 lek	6,984,232	22,623,417	9,021,750	2,513,296	41,142,695
Jo-Familjarë	Biznes i Vogël 100	000 lek	-	9	49	1	58
	Biznes i Vogël 1000	000 lek	-	15	288	-	304
	Me Këste	000 lek	585,491	1,444,912	321,687	3,676	2,355,767
	Me Këste dhe Reduktim Kamate	000 lek	-	-	1,005,347	498,464	1,503,810
	Privat Riskedulim	000 lek	-	-	41,702	51,789	93,492
	Reduktim Kamate	000 lek	-	147,672	155,151	85,685	388,508
Jo-Familjarë Total		000 lek	585,491	1,592,608	1,524,225	639,614	4,341,938
Total		000 lek	7,569,723	24,216,025	10,545,975	3,152,910	45,484,634

1. Analiza e kërkesës për energji, treguesit e humbjeve teknike dhe joteknike

- Plani i veprimeve të ndërmarra nga OSHEE në mbështetje me grupet e interesit gjatë 9Mujorit të 2017 arriti nivelin e humbjeve në 26.76% dhe parashikon që për vitin 2017 niveli i humbjeve të energjisë të arrije në 26.0%.

Bilanci Energjetik 9mujor 2017 krahasuar me vitin e mëparshëm:

TREGUESIT E BILANCIT ENERGJETIK	9M 2016	9M 2017
	(Progresive)	(Progresive)
Energji Totale në rrjetin e OSHEE Sh.a	4,690,696	4,799,261
Humbjet totale në OSHEE Sh.a	1,292,690	1,284,354
Humbjet totale në OSHEE Sh.a (%)	27.56%	26.76%
Energji e konsumuar nga klientë të kualifikuar		
Energji për klientët e OSHEE Sh.a të lidhur në rrjetin e shpërndarjes	4,690,696	4,799,261
Humbjet në OSHEE Sh.a	1,292,597	1,284,354
Humbjet në OSHEE Sh.a (%)	27.56%	29.53%
Humbjet teknike në njësitë e TL	112,817	102,122
Humbjet teknike në njësitë e TL (%)	2.41%	2.13%

2. Analiza e kërkesë – ankesave të depozituara dhe zgjedhshmëria e tyre

- Gjatë 9 Mujorit 2017 janë depozituar rreth 140 mijë kërkesë–ankesa nga të cilat rreth 58% i takojnë Teknikës dhe pjesa tjetër 42% janë çështje të shitjes. Peshën kryesore të ankesave të shitjes e zë faturimi dhe kreditimi rreth 38%.
- Gjatë po të njëjtës periudhë, janë zgjidhur rreth 126 mijë ankesë–kërkesa nga të cilat rreth 51 mijë i përkasin faturimit, pra rreth 85% e kërkesë–ankesave të depozituara janë zgjidhur.
- Me anë të nismave të ndërmarra në favor të abonentit gjatë 9 mujorit janë zgjidhur rreth 41 mijë ankesa të faturimit, nga të cilat 76.6% e tyre i përkasin keq faturimit.
- Mesatarja e ankesave mujore vs. numrin total të faturave është në nivelin < 0.5%. Ulja e numrit të ankesave të raportuara gjatë 9 mujorit 2017 duke e krahasuar me po të njëjtën periudhë të një viti më parë provon ecurinë dhe rritjen e cilësisë në shërbim dhe faturim.

Ankesat e faturimit mbi totalin e faturave të emetuara

Muaji	Nr. Faturave të emetuara	Të ardhura	Të zgjidhura	% mbi totalin e faturave
Janar	1,282,736	11,337	4,265	0.88%
Shkurt	1,195,010	7,706	5,180	0.64%
Mars	1,199,779	6,113	4,467	0.51%
Prill	1,200,343	5,421	3,934	0.45%
Maj	1,204,355	6,302	4,466	0.52%
Qershor	1,206,362	4,904	4,427	0.41%
Korrik	1,210,606	3,625	4,989	0.30%
Gusht	1,209,100	3,357	3,017	0.28%
Shtator	1,216,559	2,884	6,321	0.24%
TOTALI	10,924,850	51,649	41,066	0.47%

e. Mbrojtja e konsumatorit dhe cilësia e shërbimit të klientit

Gjatë vitit 2016 fokusi i DVT ka qënë përmirësimi i aktivitetit të marrëdhënies me klientin duke u fokusuar në

- Rritjen e cilësisë së shërbimit të klientit.
- Rritje në masën e mbulimit me qendra shërbimi – kundrejt krijimit të 90 qendrave të shërbimit dhe modernizimit të tyre.
- Përmirësimi i rregullave dhe procedurave me qëllim zgjidhjen brënda afateve kohore të kërkesa ankesave.
- Rritja e përfshirjes së rajoneve dhe agjensive në zgjidhjen e kërkesave/ankesave duke ju deleguar të drejta që lidhen me aprovimin e çështjeve dhe krijimin e qendrave të trajtimit.
- Rritja e transparencës në shërbimin e klientit kundrejt investimiti në teknologji informacioni duke realizuar :
 - o implementimin e sistemit të ndjekjes së ankesave kërkesave–për montorimin e punës së stafit të shërbimit, stafit të përfshirë në procese.
 - o ofruar mundësinë konsumatoreve që të ndjekin në çdo kohë statusin e tyre dhe përgjigjen.
 - o caktimin e hapave të qartë të punës për çdo njësi të përfshirë në shërbimet.
- Rritja e treguesve të performancës së Shërbimit në nivel rajoni dhe agjensie.

Çështjet e aktivitetit të Shitjes:

Gjatë 9 mujorit të vitit 2016 u vërejt në sportelet e shërbimit të klientit janë depozituar rreth 65 mijë ankesa – kërkesa që lidhen me aktivitetin e shitjes. Nga këto kërkesë–ankesa të paraqitura janë zgjidhur rreth 60 mijë duke arritur në nivel zgjidhshmërie 93% të totalit të ankimuar.

Niveli i zgjidhshmërisë së ankesave që lidhen me faturimin aforfe, mbifaturimin, faturime të tjera arrin në 96.4% e totalit të ankesave të depozituara.

1.6.3 Aktiviteti i Shpërndarjes

a. Situata aktuale në Rrjetin e Shpërndarjes

Gjatë periudhës 11 mujore të vitit 2017:


Kemi realizuar një sërë investimesh në ndërtim rrjeti TM 20 kV, kabina elektrike të reja, rrjet TU me përcjellësa ABC si dhe rikonstruksione të N/Stacioneve mund të përmendim:

Ecuria e investimeve për vitin 2016 – 2017

Rajoni / Viti	Kontratat 2016 dhe 2017			
	Vlera e punimeve të kontraktuara	% e kontratave	Ecuria e Punimeve në Terren	% e realizimit
Rajoni TIRANE	3,418,871,134	19.5%	2,900,699,623.78	84.8%
Rajoni ELBASAN	1,201,950,435	6.9%	953,445,638.20	79.3%
Rajoni BURREL	1,114,961,130	6.4%	940,240,121.58	84.3%
Rajoni SHKODER	1,674,002,285	9.6%	1,626,838,021.03	97.2%
Njesia KUKES	64,211,002	0.4%	64,211,001.63	100.0%
Rajoni BERAT	327,323,313	1.9%	327,323,312.56	100.0%
Rajoni DURRES	5,908,882,524	33.8%	4,906,397,194.76	83.0%
Rajoni KORCE	323,586,538	1.9%	255,992,206.89	79.1%
Rajoni GJROKASTER	1,064,778,327	6.1%	824,582,441.70	77.4%
Rajoni FIER	686,374,462	3.9%	668,921,166.47	97.5%
Rajoni VLORE	1,704,283,070	9.7%	1,424,077,154.92	83.6%
Total	17,489,224,219	100.0%	14,892,727,883.52	85.2%



**PUNIMET E REALIZUARA PER KONTRATAT TE LIDHURA SIPAS
NDARJES RAJONALE PER INVESTIME PER PROJEKTE**



**IMPAKTI NË HUMBJET E ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOMPANISË OSHEE sha
BAZUAR NË INVESTIMET E PARASHIKUARA ME FONDET E SAJ PËR VITIN 2018**


I. Humbjet Aktuale të Energjisë Elektrike (Viti 2016 dhe Janar+Shtator 2017)


I.1 Humbjet Totale të Energjisë

Humbjet Totale të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike) për vitin 2016 dhe periudhën janar - shtator 2017 për kompaninë OSHEE-sha për secilin Rajon të Shpërndarjes jepen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm :

HUMBJET TOTALE NE RRJETIN E OSHEE SH.A. VITI 2016				
Rajonet Shperndarese	Energjia e Blere	Energjia e Shitur	Humbjet	Humbjet
	MWh	MWh	MWh	%
Tirana	2,206,670	1,758,156	448,514	20.33%
Durrresi	827,502	597,244	230,259	27.83%
Fieri	393,914	317,317	76,597	19.45%
Korça	300,030	230,953	69,077	23.02%
Elbasani	389,573	306,792	82,780	21.25%
Berati	354,825	277,947	76,877	21.67%
Shkodra	673,701	387,624	286,077	42.46%
Kukesi	159,598	71,456	88,143	55.23%
Burreli	341,951	210,876	131,075	38.33%
Gjirokaster	273,713	217,068	56,645	20.70%
Vlore	319,274	226,495	92,778	29.06%
TOTAL TM & TU 2016	6,240,751	4,601,928	1,638,823	26.26%
Humbjet ne TL 2016	155,628	-	155,628	2.43%
Nevojat Vetjake	3,337	3,337	-	
Humbjet Totale OSHEE 2016	6,399,716	4,605,266	1,794,451	28.040%

HUMBJET TOTALE NE RRJETIN E OSHEE SH.A. VITI 2016 (Janar - Shtator)				
Rajonet Shperndarese	Energjia e Blere	Energjia e Shitur	Humbjet	Humbjet
	MWh	MWh	MWh	%
Tirana	1,658,137,588	1,366,553,787	291,583,801	17.59%
Durrresi	629,931,820	458,549,773	171,382,047	27.21%
Fieri	303,972,104	248,349,884	55,622,220	18.90%
Korça	226,076,161	178,179,113	47,897,048	21.19%
Elbasani	290,085,056	231,601,839	58,483,217	20.16%
Berati	269,006,488	214,297,296	54,709,191	20.34%
Shkodra	494,169,744	265,267,540	228,902,204	46.32%
Kukesi	114,430,376	49,569,613	64,860,763	56.68%
Burreli	251,455,677	158,813,484	92,642,193	36.84%
Gjirokaster	213,234,272	169,377,637	43,856,635	20.57%
Vlore	244,057,441	171,764,197	72,293,244	29.62%
TOTAL TM & TU 2017	4,694,556,726	3,512,924,162	1,182,232,564	25.18%
Humbjet ne TL 2017	102,121,764	-	102,121,764	2.13%
Nevojat Vetjake	2,582,398	2,582,398	-	
Humbjet Totale OSHEE 2017	4,799,260,888	3,514,906,560	1,284,354,328	26.76%





I.1 Humbjet Teknike

1.Humbjet Teknike të Energjisë Elektrike në Tension të Lartë (TL)

Humbjet teknike të energjisë elektrike në tension të lartë TL përfaqësojnë humbjet në nënstacionet elektrike 110/35 kV, 110/35/10/6 kV, 110/20 kV si dhe linjat elektrike transmetuese 35 kV.

Për të përcaktuar humbjet teknike të energjisë në TL është hartuar bilanci energjistik mujor për çdo Drejtori të Tensionit të Lartë/Rajon Shpërndarës i ndërtuar në bazë të skemës elektrike të operimit të rrjetit dhe pikave të matjes së energjisë elektrike me OST-në dhe Hec-et lokale të lidhur në zbarat 35/20/10/6 kV të N/stacioneve elektrike.

- Humbjet në tension të lartë sipas bilancit tregtar për vitin 2016 dhe (janar-shtator) 2017:

Rajoni / Njesia	TOTAL 2016			
	Blerje Energjie (OST+HEC-e 35/20/10/6KV) (kWh)	Konsumi Energjise (Fidera+NV+K- 35/20/10/6KV) (kWh)	Humbjet (kWh)	Humbjet (%)
Tirane	2,201,984,586	2,173,931,823	28,052,762	1.27%
Durres	872,772,047	853,547,668	19,224,379	2.20%
Fier	339,246,779	324,743,889	14,502,890	4.28%
Vlore	321,488,014	313,591,531	7,894,483	2.46%
Gjirokaster	283,964,297	273,988,446	9,975,851	3.51%
Lushnje	237,792,464	231,081,147	6,711,317	2.82%
Berat	212,203,247	199,301,964	12,901,283	6.06%
Elbasani	398,760,956	391,872,977	6,887,979	1.73%
Korçe	301,436,171	296,264,450	5,171,721	1.72%
Shkoder	694,572,767	669,516,216	25,056,552	3.61%
Kukes	165,455,368	161,977,179	4,078,189	2.46%
Burrel	369,382,861	354,211,669	15,171,192	4.11%
TOTAL	6,399,057,656	6,243,428,959	155,628,698	2.43%

Adresa : Bluëvardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njesia Administrative Nr.7, 1023, Tirane

TOTAL 2016				
NjTL	Blerje Energjie (OST+HEC-e 35kV) (kWh)	Konsumi Energjise (Fidera+NV+K-35kV) (kWh)	Humbjet (kWh)	Humbjet (%)
Tirane	3,074,756,633	3,027,479,491	47,277,142	1.54%
Fier	1,182,489,554	1,143,405,013	39,084,541	3.31%
Elbasan	912,400,373	887,439,391	24,960,982	2.74%
Burrel	1,229,410,997	1,185,105,064	44,305,932	3.60%
TOTAL	6,399,057,556	6,243,428,959	155,628,598	2.43%

Bilanci i Humbjeve te Energjise ne Tension te Larte sipas RSH-ve (Janar ÷ Shtator) 2017				
Rajoni / Njesia	Blerje Energjie (OST+HEC-e 35/20/10/6kV) (kWh)	Konsumi Energjise (Fidera+NV+K- 35/20/10/6kV) (kWh)	Humbjet (kWh)	Humbjet (%)
Tirane	1,653,360,057	1,632,495,605	20,864,452	1.3%
Durres	664,606,256	651,230,708	13,375,549	2.0%
Fier	255,069,672	246,405,444	8,664,228	3.4%
Vlore	244,463,661	241,185,231	3,278,430	1.3%
Gjirokaster	218,312,250	213,241,350	5,070,900	2.3%
Berat	342,652,568	330,256,042	12,396,527	3.6%
Elbasani	296,139,059	291,903,399	4,235,660	1.4%
Korçe	227,384,410	223,203,608	4,180,802	1.8%
Shkoder	509,456,176	491,155,670	18,300,506	3.6%
Kukes	120,263,304	116,438,817	3,824,487	3.2%
Burrel	267,553,474	259,623,252	7,930,223	3.0%
TOTAL	4,799,260,888	4,697,139,125	102,121,763	2.13%

Bilanci i Humbjeve te Energjise ne Tension te Larte sipas NjTL-ve (Janar ÷ Shtator) 2017				
NjTL	Blerje Energjie (OST+HEC-e 35kV) (kWh)	Konsumi Energjise (Fidera+NV+K-35kV) (kWh)	Humbjet (kWh)	Humbjet (%)
Tirane	2,317,966,314	2,283,726,313	34,240,001	1.48%
Fier	903,718,994	881,558,341	22,160,653	2.45%
Elbasan	680,302,626	664,636,733	15,665,894	2.30%
Burrel	897,272,954	867,217,738	30,055,216	3.35%
TOTAL	4,799,260,888	4,697,139,125	102,121,763	2.13%


Për vitin 2016 humbjet e energjisë elektrike në tension të lartë kanë qenë 2.43 % ndërsa për 9-mujorin e vitit 2017 rezultojnë në vlerën 2.13 % .

2. Humbjet në rrjetin e Tensionit të Mesëm (TM 6/10/20 kV)

Rrjeti TM përbëhet nga këto nivele tensioni 35, 20 kV, 10 kV dhe 6 kV (humbjet në linjat TM 35kV janë përfshirë në përcaktimin e humbjeve TL). Linjat janë dizenuar si ajrore ose kablllore. Rezultatet e llogaritjeve empirike të humbjeve mujore/vjetore bazuar në konsumet ditore operative në tension të mesëm pasqyrohen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm :
Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepet total i humbjeve teknike në rrjetin TU për vitet 2016 dhe janar-shtator 2017 të ndarë sipas rajoneve/njësive.

HT_TM 2016 dhe (Janar - Shtator) 2017			
Nr.	RSH	Humbjet ne TM 2016 (%)	Humbjet ne TM 2017 (%)
1	Shkoder	9.34%	8.94%
2	Kukes	10.29%	10.06%
3	Burrel	10.06%	9.60%
4	Tirane	3.80%	3.06%
5	Durres	6.86%	4.51%
6	Elbasan	7.11%	6.97%
7	Korce	6.77%	6.46%
8	Berat	8.46%	7.41%
9	Fier	7.17%	6.41%
10	Gjirokaster	9.12%	8.04%
11	Vlore	6.13%	5.57%
	Total	6.47%	5.62%

Ne tabelen dhe grafikun e meposhtem jepet total i humbjeve teknike ne rrjetin TU per vitet 2016 dhe janar-shtator 2017 te ndare sipas rajoneve/njesive.



3. Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin TU


Rrjeti TU (me tension nominal 230/400 V) është i përbërë nga linjat ajrore me përcjelles të zhveshur, linjat ajrore kabllore me kabell me vetëmbajtje ABC si dhe nga linjat kabllore. Linjat Ajrore janë më së shumti me përcjellesa të zhveshur.

3.Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin TU

Rrjeti TU (me tension nominal 230/400 V) është i përbërë nga linjat ajrore me përcjellës të zhveshur, linjat ajrore kabllore me kabell me vetëmbajtje ABC si dhe nga linjat kabllore. Linjat ajrore janë më së shumti me përcjellesa të zhveshur.

Ne tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepet total i humbjeve teknike në rrjetin TU për vitet 2016 dhe janar-shtator 2017 të ndarë sipas rajoneve/njësiteve.

HT_TU 2016 dhe (Janar - Shtator) 2017			
Nr.	RSH	Humbjet ne TU 2016 (%)	Humbjet ne TU 2017 (%)
1	Shkoder	13.10%	12.70%
2	Kukes	20.55%	20.31%
3	Burrel	20.66%	20.20%
4	Tirane	9.40%	8.67%
5	Durres	6.25%	3.90%
6	Elbasan	7.34%	7.21%
7	Korce	10.56%	10.25%
8	Berat	10.00%	8.95%
9	Fier	8.54%	7.78%
10	Gjirokaster	7.60%	6.52%
11	Vlore	10.55%	9.99%
Total		10.33%	10.05%




Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Në tabelën e mëposhtme jepen në mënyrë të përmblëdhur humbjet teknike në total për secilin nivel tensioni TL/TM/TU për secilin rajon/njësi për vitin 2016 dhe 9-mujorin e vitit 2017 :

Humbjet teknike ne rrjetin e OSHEE sha Viti 2016					
Nr.	RSH	Humbjet ne TL (%)	Humbjet ne TM (%)	Humbjet ne TU (%)	Humbjet Teknike (%)
1	Shkoder	3.61%	9.34%	13.10%	26.05%
2	Kukes	2.46%	10.29%	20.55%	33.30%
3	Burrel	4.11%	10.06%	20.66%	34.84%
4	Tirane	1.27%	3.80%	9.40%	14.47%
5	Durres	2.20%	6.86%	6.25%	15.32%
6	Elbasan	1.73%	7.11%	7.34%	16.17%
7	Korce	1.72%	6.77%	10.56%	19.04%
8	Berat	4.36%	8.46%	10.00%	22.82%
9	Fier	4.28%	7.17%	8.54%	19.98%
10	Gjirokaster	3.51%	9.12%	7.60%	20.23%
11	Vlore	2.46%	6.13%	10.55%	19.14%
Total		2.43%	6.47%	10.33%	19.24%

HT_TM dhe TU per (Janar - Shtator) 2017					
Nr.	RSH	Humbjet ne TL (%)	Humbjet ne TM (%)	Humbjet ne TU (%)	Humbjet Teknike (Janar + Shtator 2017)
1	Shkoder	3.59%	8.94%	12.70%	25.23%
2	Kukes	3.18%	10.06%	20.31%	33.55%
3	Burrel	2.96%	9.60%	20.20%	32.77%
4	Tirane	1.26%	3.06%	8.67%	12.99%
5	Durres	2.01%	4.51%	3.90%	10.42%
6	Elbasan	1.43%	6.97%	7.21%	15.61%
7	Korce	1.84%	6.46%	10.25%	18.56%
8	Berat	3.62%	7.41%	8.95%	19.98%
9	Fier	3.40%	6.41%	7.78%	17.59%
10	Gjirokaster	2.32%	8.04%	6.52%	16.88%
11	Vlore	1.34%	5.57%	9.99%	16.89%
Total		2.13%	5.62%	10.05%	17.80%



Në tabelën e mëposhtme jepen humbjet teknike në përqindje të ndarë sipas niveleve të tensionit në bazë të energjisë elektrike aktive që ushqejnë këto rrjeta të tensionit për vitet 2016 dhe janar-shtator 2017:

Un (kV)	HT % _V.2016	HT % 9M.2017
35	6.54	5.95
6	9.17	8.18
10	9.62	9.1
20	2.21	2.31
0.4	11.61	10.05

PERFORMANCA E RRJETIT SHPËRNDARËS (2016 DHE JANAR÷ SHTATOR 2017)

I.1 Analiza e performancës së furnizimit sipas Drejtorive Rajonale dhe njësive të Tensionit të Lartë

Performanca e furnizimit të rrjetit shpërndarës TL-TM-TU për vitin 2016 dhe Janar-Shtator 2017 për secilin Rajon të Shpërndarjes dhe Njësi të tensionit të lartë jepen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm :


Rrjeti TM-TU				
Rajonet	SAIFI 2016	SAIFI 2017	SAIDI 2016	SAIDI 2017
Tirane	35.18	18.68	67.26	29.73
Durres	38.66	9.28	74.04	16.68
Berat	37.91	31.29	75.62	40.77
Korce	26.41	16.16	51.66	22.29
Elbasan	28.41	24.43	72.20	52.20
Fier	37.84	21.67	79.19	33.60
Vlore	35.91	23.09	90.38	38.68
Gjirokaster	54.06	26.45	69.70	31.06
Burrel	75.16	34.35	145.28	60.87
Kukes	84.88	49.54	146.90	59.28
Shkoder	44.33	24.96	121.45	59.28
Total Drejtori	45.34	25.44	90.33	40.40



PERFORMANCA E RRJETIT TL				
Rajonet	SAIFI 2016	SAIFI 2017	SAIDI 2016	SAIDI 2017
Qender	7.30	4.70	14.03	5.77
Jug-Perendim	11.19	7.40	25.41	10.09
Jug-Lindje	8.30	6.90	18.26	9.82
Veri	9.50	7.80	16.82	16.12
Total TL	9.07	6.70	18.63	10.45

Treguesi i performances SAIFI per Rrjetin TM/TU sipas Drejtorive Rajonale



Treguesi i performances SAIDI per Rrjetin TM/TU sipas Drejtorive Rajonale





I.2 Performanca e furnizimit të rrjetit Shpërndarës, llogaritur sipas kërkesave të ERE

Performanca e rrjetit TL përfaqëson, performancën e furnizimit të nënstacioneve 110/35/20/10/6kV dhe rrjetit TL 35kV. Difektet në këtë rrjet janë të klasifikuara në difekte në nënstacione, në transformatorë të fuqisë, në çelësa 110/35/20/10/6kV, linja 35kV dhe tek klasifikimi të tjera përfshihen difektet në mbrojtje, rrymën operative apo nenvoja vetiake.


Sejcili prej këtyre zërave zë peshë specifike të ndryshme në performancën e përgjithëshme të rrjetit shpërndarës, peshë e cila ndryshon nga viti në vit në varësi të investimeve apo mirëmbajtjes së kryer.

Llogaritjet kryen mbi bazë të regjistrimit në Dispeçerinë Qëndrore TL të gjithë llojeve të ndërprerjeve të cilat më pas përpunohen duke u klasifikuar sipas zërave dhe shkaqeve që kanë

quar në këto stakime që mund të jenë forca madhore, të tretë, difekte me përgjegjësi të OSHEE-së, investime, masa sigurie, remonte, kufizime energjie.


Treguesit e performancës Viti 2016

Emertimi I rrjetit	Janar-Dhjetor 2016	
	SAIFI	SAIDI
Total MV	34.4	78.2
Total HV	8.8	18.9
Total MV + HV	43.1	97.1



Treguesit e performancës Janar-Shtator 2017

Emertimi I rrjetit	Janar-Shtator 2017	
	SAIFI	SAIDI
Total MV	4.9	10.2
Total HV	19.8	39.3
Total MV + HV	24.8	49.5



Konstatohet se gjatë vitit 2017 ka përmirësim të treguesve të furnizimit

Emertimi i rrjetit	Janar -Shtator 2017		Janar -Shtator 2016		Përmirësimi në %	
	SAIFI	SAIDI	SAIFI	SAIDI	SAIFI	SAIDI
Total HV	4.9	10.2	6.4	14.6	23%	30%
Total MV	19.8	39.3	24.9	55.7	20%	29%
Total MV + HV	24.8	49.5	31.3	70.3	21%	30%

- SAIFI është përmirësuar 21%
- SAIDI është përmirësuar 30%



I.3 Performanca e furnizimit të rrjetit TM-TU dhe pesha specifike që zënë në performancën e rrjetit shpërndarës Viti 2016 dhe Janar-Shtator 2017

Performanca e rrjetit shpërndarës TM-TU përfaqëson, performancën e furnizimit të linjave 20/10/6kV, kabinave të cilat janë dhe zërat e klasifikimit të difekteve në këtë rrjet. Treguesit e performancës SAIDI dhe SAIFI i këtij rrjeti llogaritet bazuar në regjistrimin e të gjithë llojeve të ndërprerjeve nga ana e 11 dispecerive rajonale TM-TU në varësi të Drejtorive Rajonale.

Sejçili nga këto zëra zë peshë specifike të ndryshme dhe konstatohet se mungesa e investimeve në kabina ka çuar në rritje të peshës specifike që zënë difektet në kabina për vitet 2015 dhe 2016 respektivisht nga 7% në 17%.

Emertim	Viti 2016	Peshes spec në përqindje % Vjetor
Linje 35kV	3.11	7%
N/St	2.32	5%
Transformator Fuqie	1.30	3%
Celes fidrië/10/20/35	1.65	4%
Te tjera	0.42	1%
Fidera	26.73	62%
Kabina	7.35	17%
TOTAL TM	34.35	79%
Total TL	8.79	21%
TOTAL SAIF	43.14	100%

Emertim	Viti 2016	Peshes spec në përqindje % Vjetor
Linje 35kV	7.99	8%
N/St	4.59	5%
Transformator Fuqie	2.56	3%
Celes fidrië/10/20/35	3.21	3%
Te tjera	0.56	1%
Fidera	67.14	69%
Kabina	10.65	11%
TOTAL TL	18.26	19%
Total TM	78.15	80%
TOTAL SAIF	97.05	100%



Periudha Janar-Shtator 2017:

PESHA SPECIFIKE SAIFI Janar-Shtator 2017

Emertim	Janar-Shtator 2017	Peshes spec ne perqindje % Vjetor
Linje 35kV	1.47	6%
N/St	1.35	5%
Transformator Fuqje	0.99	4%
Celes fidri6/10/20/35	1.02	4%
Te tjera	0.09	0%
Fidera	15.86	64%
Kabina	3.97	16%
TOTAL TM	19.84	80%
Total TL	4.92	20%
TOTAL SAIF	24.76	100%

PESHA SPECIFIKE SAIDI Janar-Shtator 2017

Emertim	Janar-Shtator 2017	Peshes spec ne perqindje % Vjetor
Linje 35kV	3.24	7%
N/St	2.60	5%
Transformator Fuqje	2.14	4%
Celes fidri6/10/20/35	2.05	4%
Te tjera	0.12	0%
Fidera	33.67	68%
Kabina	5.65	11%
TOTAL TL	10.15	21%
Total TM	39.32	79%
TOTAL SAIF	49.47	100%



Krahasimi i peshës specifike që zënë komponentet e rrjetit shpërndarës në treguesit SAIDI dhe SAIFI për vitin 2016 dhe Janar – Shtator 2017

PESHA SPECIFIKE SAIDI		
Emertim	Peshes spec viti 2016	Peshes spec Janar-Shtator 2017
Linje 35kV	8%	7%
N/St	5%	5%
Transformator Fuqie	3%	4%
Celes fidris/10/20/35	3%	4%
Te tjera	1%	0%
Fidera	69%	68%
Kabina	11%	11%
TOTAL TL	19%	21%
Total TM	80%	79%
TOTAL SAIF	100%	100%





PESHA SPECIFIKE SAIFI		
Emertim	Peshes spec viti 2016	Peshes spec Janar-Shtator 2017
Linje 35kV	7%	6%
N/St	5%	5%
Transformator Fuqie	3%	4%
Celes fidris/10/20/35	4%	4%
Te tjera	1%	0%
Fidera	62%	64%
Kabina	17%	16%
Total TL	21%	20%
TOTAL TM	79%	80%
TOTAL SAIF	100%	100%



Konkluzion: OSHEE ka realizuar investimet të shpërndarë në të gjitha komponentët e rrjetit TL-TM si linja TM, kabina, transformatorë fuqie, çela në impiantet e nënstacioneve, çelsa 110/35/20/10/6kV në nënstacione, linja 35kV, kontroll testim të paisjeve të tensionit të lartë dhe të mbrojtjes sekondare, evidentim dhe ndërhyrje në nyje kritike, realizim të mirëmbajtjes-shfrytëzimit-operimit sipas rregullores së shfrytëzimit të rrjetit shpërndarës mbështetur me aparatura kontrolli-testimi-monitorimi, dhe si rezultat ndryshimi i peshës specifike për secilin komponent është shumë i vogël 1-2%.

I.4 Analiza e numrit të ndërprerjeve në rrjetin shpërndarës.

Per vitin 2016 numri i ndërprerjeve në rrjetin shpërndarës ka qenë 30,869 dhe për periudhën Janar-Shtator 2017 është 18,484 nga të cilat 636 janë kryesisht dëmtime në rrjet nga të tretët apo kërkesë për masë sigurie në kryerjen e punimeve.



2.1 Analiza e numrit të stakimeve në rrjetin TL/TM/TU

Numri I nderprerjeve Viti 2016 dhe Janar-Shtator 2017

Total	Nr nderprerje te planifikuar	Nr nderprerje forca meqndore	Nr stakime per te treta	Nr stakime OSHEE
Total HV 2016	1284	172	82	1113
Tot MV 2016	3534	1523	953	29756
Total 2016	4818	1695	1035	30869
Total HV Janar-shtator 2017	870	81	53	667
Tot MV Janar-shtator 2017	3007	880	583	17817
Total Janar -Shtator 2017	3877	961	636	18484






Tabela e numrit të ndërprerjeve për periudhen Janar-Shtator 2016

	Nderprerje e Planifikuar	Force Madhore	Pergjegjesi e paleve te treta	Pergjegjesi e OSHEE
Total TL	915	141	73	747
Tot TM	2331	1234	678	21847
Total	3246	1375	751	22594

Konkluzion: Numri total i ndërprerjeve në Janar-shtator 2017 krahasuar për të njëjtën periudhë Janar-Shtator të vitit 2016 është zvogëluar me 22%.

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

II. PARASHIKIMI I KËRKESES PËR ENERGJI

2.1 Të Dhënat dhe Metodologjia Bazë

Të dhënat historike të përdorura në parashikimin e energjisë totale në rrjetin e shpërndarjes dhe konsumit të energjisë për të gjithë konsumatorët e OSHEE sh.a janë marrë nga:


- Bilanci Energjitik për periudhën Janar 2007-Shtator 2017.
- Strukturat e Shitjes për periudhën Janar 2009–Shtator 2017.

Parashikimi i Energjisë Elektrike është bërë duke supozuar :

- që në portofolin e OSHEE të jenë të gjithë konsumatorët aktualë,
- si dhe duke marrë parasysh parashikimin e ligjit 43/2015 për shkëputjen e klientëve në 35 kv në 2018, 20kv në 2019, 10 kv në 2020 dhe 6 kv në 2021.

Duke supozuar vazhdimin e sjelljes së konsumatorëve në mënyrë të ngjashme me konsumin historik të viteve të mëparshme, modeli i përdorur për parashikim është bazuar në trend dhe sezonalitet. Gjithashtu janë marrë në konsideratë dhe elemente të tjerë siç është plani që OSHEE sh.a ka për reduktimin e humbjeve për vitet 2018-2022.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet trendi i Energjisë Elektrike të Blerë, Energjisë së Shitur dhe Humbjeve në Rrejt për vitet 2007-2022.



Trendi i Energjisë Elektrike

2.2 Parashikimi i Energjisë Totale për OSHEE sh.a

Parashikimi i energjisë totale për OSHEE për vitin 2018 është mbështetur mbi totalin e parashikuar për vitin 2017, duke aplikuar një normë vjetore rritjeje. Kjo normë rritje është bazuar në disa faktorë si më poshtë:

- norma mesatare e rritjes në konsumin e energjisë elektrike në shkallë vendi gjatë periudhës 5-vjeçare 2012-2016;
- pritshmëritë tona për ecurinë e konsumit për këtë periudhë.
- rritjen e numrit të konsumatorëve.
- plani i reduktimit të humbjeve.

Pasi është parashikuar energjia totale për vitet 2018 dhe 2019-2022 në total, shpërndarja e tyre sipas muajve është bërë sipas peshës së konsumit që zë çdo muaj në konsumin total të energjisë gjatë vitit. Këto pesha janë llogaritur në bazë të të dhënave historike 2007–Shtator 2017, duke marrë parasysh efektin e stinës në sjelljen e konsumit të energjisë nga njeri muaj në tjetrin.

2.3 Parashikimi i humbjeve teknike dhe joteknike

Parashikimi i humbjeve teknike dhe jo teknike për vitet 2018-2022

	Njesia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Energjia në Rrjet	MWh	6,494,866	6,399,716	6,472,419	6,320,012	6,296,628	6,277,738	6,258,905	6,935,245
Energji e shitur	MWh	4,459,444	4,605,264	4,789,590	4,803,209	4,911,370	5,022,190	5,132,302	5,911,288
Humbjet	MWh	2,035,422	1,794,452	1,682,829	1,516,803	1,385,258	1,255,548	1,126,603	1,023,957
Humbjet %	%	31.3%	28.0%	26.0%	24.5%	24.0%	20.0%	18.0%	14.8%
Teknike	%	21.0%	21.0%	19.2%	17.9%	17.7%	14.8%	13.8%	13.0%
Jo Teknike	%	10.6%	7.0%	6.8%	6.6%	6.3%	5.2%	4.2%	1.8%

Në tabelën e mësipërme janë reflektuar të dhënat e humbjeve faktike për vitet 2014-2016, parashikimi për vitin 2017 (9M faktik dhe 3M parashikim), si dhe parashikim për vitet 2018-2022.

Treguesit e bilancit energjistik 2017 vs 2013-2016 (GWh)

Treguesit e Bilancit 2013	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt	Dhjet	Total 2013
Energji Blerë	744	665	674	546	503	511	547	566	493	533	590	774	7,145
Energji Fat.	364	341	348	329	304	305	310	348	320	288	306	364	3,927
Humbje	380	324	325	216	199	206	237	218	173	245	284	411	3,218
Humbje %	51.1%	48.7%	48.3%	39.7%	39.5%	40.3%	43.3%	38.5%	35.1%	46.0%	48.1%	53.0%	45.04%

Treguesit e Bilancit 2014	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt	Dhjet	Total 2014
Energji Blerë	733	632	646	579	541	501	531	556	492	537	546	640	6,935
Energji Fat.	389	365	370	372	342	330	336	354	336	352	367	400	4,313
Humbje	345	266	276	207	199	171	194	202	156	185	180	240	2,622
Humbje %	47.0%	42.1%	42.8%	35.7%	36.8%	34.1%	36.6%	36.4%	31.7%	34.5%	32.9%	37.5%	37.81%

Treguesit e Bilancit 2015	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt	Dhjet	Total 2015
Energji Blerë	686	592	595	514	472	466	536	529	459	477	519	649	6,495
Energji Fat.	434	404	399	357	325	333	372	374	343	334	359	425	4,459
Humbje	252	188	196	157	148	133	164	155	116	143	160	224	2,035
Humbje %	36.7%	31.8%	32.9%	30.5%	31.2%	28.6%	30.6%	29.3%	25.3%	29.9%	30.8%	34.5%	31.34%

Treguesit e Bilancit 2016	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt	Dhjet	Total 2016
Energji Blerë	672	560	573	470	477	463	510	514	451	480	540	689	6,400
Energji Fat.	439	397	402	347	349	350	377	385	351	350	382	475	4,605
Humbje	233	162	172	122	129	113	132	129	100	130	158	213	1,794
Humbje %	34.7%	29.0%	29.9%	26.1%	27.0%	24.4%	25.97%	25.15%	22.12%	27.1%	29.3%	31.0%	28.04%

Treguesit e Bilancit 2017	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt	Dhjet	Total 2017
Energji Blerë	716	562	545	494	475	485	530	542	450	483	534	657	6,472
Energji Fat.	476	407	389	366	352	349	399	416	361	368	408	498	4,790
Humbje	240	155	156	127	123	137	131	126	89	115	125	159	1,683
Humbje %	33.5%	27.6%	28.7%	25.8%	25.9%	28.1%	24.7%	23.3%	19.8%	23.8%	23.4%	24.1%	26%

Nga sa më sipër referuar treguesve të bilancit energjistik, nga ku mungon energjia e shitur ka një përmirësim të dukshëm të treguesve për vitin 2017 në raport me vitet 2016, 2015, 2014, dhe sidomos në raport me vitin 2013. Mbyllja e vitit 2017 tregon se energjia e hyrë në rrjet është 673 GWh më e ulët krahasuar me 2013 ndërsa energjia e faturuar ka shënuar një rritje 862 GWh krahasuar po ashtu me vitet 2016-2014, kjo si pasojë e uljes së humbjeve në rrjet me 19 % për 2017 krahasuar me 2013.

Rezultatet e sipërpërmëndura janë rrjedhojë e menaxhimit efikas i cili konsiston në:

- Rritjen e kontrolleve në terren për reduktimin e abuzimeve në rrjet.
- Rritjen e kontrolleve të brëndshme me qëllim faturimin sa më korrekt të konsumatorit.
- Ndërgjegjësimin e konsumatorit për rëndësinë e mos shpërdorimit të Energjisë Elektrike.
- Investimeve në rrjet, etj..

Treguesit e bilancit energjistik krahasimor 2017 vs 2013-2016

Sipas Bilancit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
<i>Energji e Blere GWh</i>													
<i>2017 vs 2016</i>	44	2	-28	24	-2	22	20	28	-1	2	-6	-32	73
<i>2017 vs 2015</i>	30	-30	-50	-21	3	20	-6	13	-9	6	14	8	-22
<i>2017 vs 2014</i>	-18	-69	-101	-85	-66	-16	-1	-14	-43	-55	-13	17	-463
<i>2017 vs 2013</i>	-28	-103	-128	-52	-28	-26	-17	-24	-43	-50	-56	-117	-673

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Energji e Faturuar GWh													
<u>2017 vs 2016</u>	37	9	-13	19	3	-2	22	31	10	18	27	23	184
<u>2017 vs 2015</u>	42	3	-10	9	27	16	27	42	18	34	49	73	330
<u>2017 vs 2014</u>	87	41	19	-6	10	19	63	62	24	16	42	98	476
<u>2017 vs 2013</u>	112	66	41	37	48	44	89	68	41	80	102	135	862
Humbjet GWh													
<u>2017 vs 2016</u>	7	-7	-15	5	-6	24	-2	-3	-11	-16	-33	-55	-112
<u>2017 vs 2015</u>	-12	-33	-39	-30	-25	3	-33	-29	-27	-28	-35	-65	-353
<u>2017 vs 2014</u>	-105	-111	-120	-79	-76	-34	-63	-76	-67	-71	-55	-82	-939
<u>2017 vs 2013</u>	-140	-169	-169	-89	-76	-70	-106	-92	-84	-130	-158	-252	-1,535
Humbjet %													
<u>2017 vs 2016</u>	-1%	-1%	-1%	0%	-1%	4%	-1%	-2%	-2%	-3%	-6%	-7%	-2%
<u>2017 vs 2015</u>	-3%	-4%	-4%	-5%	-5%	0%	-6%	-6%	-6%	-6%	-7%	-10%	-5%
<u>2017 vs 2014</u>	-14%	-15%	-14%	-10%	-11%	-6%	-12%	-13%	-12%	-11%	-9%	-13%	-12%
<u>2017 vs 2013</u>	-18%	-21%	-20%	-14%	-14%	-12%	-19%	-15%	-15%	-22%	-25%	-29%	-19%

a) Plani i reduktimit të humbjeve

- Nisur nga plani i reduktimit të humbjeve që OSHEE ka për vitin 2018, është parashikuar që nëpërmjet investimeve në rrjet, humbjet teknike do të reduktohen në 16.8% për 2018 dhe humbjet jo teknike në 7.7%. Humbjet totale në rrjetin e OSHEE për vitin 2018 të parashikuara janë 24.5 %. Parashikimi i humbjeve për vitin 2018 është ulur me 1.5 % krahasimisht me vitin 2017.
- Referuar ligjit për sektorin e energjisë elektrike Nr 43/2015 miratuar në datë 30.4.2015 Neni 109 i cili thotë që: Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se data 30 qershor 2016, klientët e lidhur në tension 20 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016, ndërsa klientët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kV dhe 0,6 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2017. Klientët e lidhur në tension 0,4 kV kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre

Parashikimi 2018

Viti 2018 (MWh)	
Energji e Blerë 2018	6,320,012
Energji e Shitur 2018	4,803,209
Humbje Mwh	1,516,803
Humbje %	24.00%

Bazuar në parashikimin vjetor të energjisë së injektuar dhe të energjisë së faturuar, pasi kemi llogaritur peshat që zë çdo muaj në konsumin vjetor kemi bërë shpërndarjen mujore për vitin 2018, koeficientët mujorë janë llogaritur duke marrë paraasysh vitin 2017 dhe duke qënë se ky vit përfaqëson një trend të normalizuar të konsumeve si pasojë e reflektimit të aksioneve të

ndërmara nga OSHEE për reduktimin e humbjeve jo teknike që konsistojnë në uljen e abuzimeve dhe vjedhjeve, si dhe në planin e uljes së humbjeve teknike nëpërmjet investimeve.

Parashikimi për vitin 2018 sipas muajve (GWh)

Viti 2018	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nënt	Dhjetor	2018
Energji e Blerë	701	567	565	487	481	460	506	510	449	467	508	621	6,320
Energji e Shitur	481	423	416	375	369	366	397	405	370	364	385	452	4,803
Humbjet	220	144	149	111	112	94	108	105	79	103	123	169	1,517
Humbjet %	31.4%	25.4%	26.4%	22.9%	23.3%	20.4%	21.4%	20.6%	17.6%	22.0%	24.2%	27.2%	24.0%

Treguesit e Bilancit Energjisë 2015-2021

2.4 Parashikimi i energjisë së shitur sipas strukturës së shitjes (përfshirë dhe konsumatorin 35 kV)

OSHEE Sh.a STRUKTURA E SHITJES 2018

Niveli i Tensionit	Grupet e Klieve te	Çmimi (Lek/kWh)			Sasia e energjise se fakturuar			Te ardhurat nga energjia e fakturuar		
		Aktiv	Reaktiv	Ne P.B.	Aktiv (kWh)	Reaktiv (kVArh)	Ne P.B (kWh)	Aktiv (Lek)	Reaktiv (Lek)	Ne P.B (Lek)
Tension i Mesem	Industri	9.50	1.43	10.93	24,916,997	3,580,314	1,009,367	236,711,468	5,101,947	11,027,340
	Tregeti dhe Sherbime	9.50	1.43	10.93	27,157,762	3,207,043	3,903,125	257,998,740	4,570,037	42,641,635
	Bujqesi	9.50	1.43	10.93	-	-	-	-	-	-
	Te Tjera	9.50	1.43	10.93	544,569	697,709	-	5,173,406	994,236	-
	Kliente te Lidhur ne 35 kV				52,619,328	7,485,067	4,912,492	499,883,613	10,566,220	53,668,975
	Industri	11.00	1.65	12.65	210,269,802	80,921,165	9,428,679	2,312,967,820	133,519,922	119,272,795
	Tregeti dhe Sherbime	11.00	1.65	12.65	102,402,984	6,801,209	5,675,421	1,126,432,824	11,221,994	71,794,080
	Prodhim Miell, Buke dhe nenprodukte	7.10	1.14	8.74	-	-	-	-	-	-
	Bujqesi	11.00	1.65	12.65	-	-	-	-	-	-
	Te Tjera	11.00	1.65	12.65	100,895,358	7,479,489	15,450,775	1,109,848,937	12,341,157	195,452,301
	Buxhetore	11.00	1.65	12.65	16,406,875	376,633	121,608	180,475,624	621,445	1,538,340
	Konsum Vetjak ne TM	11.00	1.65	12.65	-	-	-	-	-	-
	Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TM				429,975,019	95,578,495	30,676,483	4,729,725,205	157,704,518	388,057,515
	Industri	12.40	1.86	14.26	59,140,892	22,147,310	2,967,587	733,347,055	41,193,997	42,317,796
	Tregeti dhe Sherbime	12.40	1.86	14.26	86,678,885	11,925,960	3,560,510	1,074,818,171	22,182,286	50,772,878
	Prodhim Miell, Buke dhe nenprodukte	12.40	1.86	14.26	-	-	-	-	-	-
	Objekte fetare TM	9.50	1.43	10.93	264,454	8,069	38,658	2,512,315	11,499	422,340
	Bujqesi	12.40	1.86	14.26	1,893,171	146,207	2,067	23,475,322	271,945	29,476
	Te Tjera	12.40	1.86	14.26	44,250,586	3,073,201	3,522,817	548,707,272	5,716,155	50,235,372
	Buxhetore	12.40	1.86	14.26	10,826,399	308,807	1,384,340	134,247,344	574,381	19,740,683
	Konsum Vetjak ne TM	12.40	1.86	14.26	-	-	-	-	-	-
	Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TU (kabine me nje abonent)				293,054,387	37,609,555	11,475,980	2,517,107,480	69,950,262	163,518,546
	Industri	14.00	2.10	16.10	42,312,023	11,361,707	2,538,064	592,368,323	23,859,585	40,862,828
	Tregeti dhe Sherbime	14.00	2.10	16.10	71,186,901	5,046,597	6,524,607	996,616,610	10,597,853	105,046,171
	Prodhim Miell, Buke dhe nenprodukte	7.60	1.14	8.74	7,294,842	2,607,494	692,144	55,440,800	2,972,543	6,049,343
	Objekte fetare TM	9.50	1.43	10.93	425,065	3,872	40,360	4,038,121	5,517	440,936
	Bujqesi	14.00	2.10	16.10	683,821	405,473	39,298	9,573,488	851,494	632,693
	Te Tjera	14.00	2.10	16.10	66,704,295	13,670,430	2,482,378	933,860,126	28,707,903	39,966,287
	Buxhetore	14.00	2.10	16.10	28,352,714	928,325	1,760,919	396,937,993	1,949,482	28,350,791
	Konsum Vetjak ne TM	14.00	2.10	16.10	11,214	-	-	156,990	-	-
	Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TU (Kabine me shume se nje abonent)				216,970,874	34,023,898	14,077,770	2,988,992,450	68,944,378	221,349,049
Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Total				850,000,279	167,211,948	56,230,233	10,235,825,135	296,599,157	772,925,110	
Total ne TM				992,419,607	174,697,015	61,142,725	10,735,708,749	307,345,877	676,694,088	
Tension i Ulët	Industri	14.00	2.10	16.10	6,644,325	1,227,597	50,896	93,020,544	2,577,953	819,426
	Tregeti dhe Sherbime	14.00	2.10	16.10	881,731,256	15,376,186	4,568,812	12,344,237,590	32,289,991	73,557,866
	Prodhim Miell, Buke dhe nenprodukte	7.60	1.14	8.74	72,326,875	1,609,142	468,485	549,684,253	1,834,421	4,094,557
	Objekte fetare TM	9.50	1.43	10.93	2,471,901	4,624	32,781	23,483,055	6,590	358,133
	Bujqesi	14.00	2.10	16.10	4,319,224	249,790	-	60,469,135	524,559	-
	Te Tjera	14.00	2.10	16.10	68,618,944	3,774,285	2,066,832	960,665,220	7,925,998	33,275,989
	Buxhetore	14.00	2.10	16.10	134,235,343	2,232,760	1,870,793	1,879,294,800	4,688,795	30,119,774
	Konsum Vetjak ne TU	14.00	2.10	16.10	5,997,465	1,009	-	83,964,515	2,119	-
	Ambjentet e Perbashketa private	9.50	-	-	4,520,982	-	-	42,949,330	-	-
	Kliente te lidhur ne TU (jo familjare)				1,180,866,315	24,475,392	9,058,598	16,037,768,442	49,850,426	142,225,745
	Biloku i dyte mbi 300 kWh	9.50	-	-	2,573,854,911	-	-	24,451,621,654	-	-
	Ambjente te Perbashketa Familjare	9.50	-	-	75,666,864	-	-	718,835,212	-	-
	Familjare				2,649,521,775	-	-	25,170,456,866	-	-
	Total ne TU				4,809,216,823	24,475,392	9,058,598	41,208,215,308	49,850,426	142,225,745
	Sherbime fikse te tarifuar per konsumin "0 kWh"							638,308,571		
Totali i shërbimeve me tarifa fikse							638,308,571			
SHUMA				4,713,007,588	398,172,407	70,201,304	52,562,740,519	367,115,829	393,819,511	
Energjia Totale e shitur nga OSHEE Sh.a (sipas Bilancit te Energjise)				4,809,216,823			64,699,819,915			

Struktura e shitjes sipas kategorive (grupeve të klientëve) të llogaritur duke marrë për referencë sasinë e energjisë së shitur të vitit 2017 me peshë specifike në sasinë e energjisë së parashikuar

të shitet për vitin 2018, ndërsa të ardhurat nga energjia LEK sipas tarifave (çmimeve) të miratuara nga ERE për kategoritë në nivel tensioni.

Niveli i Tensionit	Grupet e Klienteve	Sasia e energjise se faturuar			
		Aktive (kWh)	Reaktive (kVArh)	Ne pik (kWh)	Demi Ekonomik (kWh)
	Kliente te Lidhur ne 35 kV	52,619,328	7,485,067	4,912,492	-
	Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Total	850,000,279	167,211,948	56,230,233	-
	Total ne TM	902,619,607	174,697,015	61,142,725	-
	Kliente te lidhur ne TU (jo familjare)	1,180,866,315	24,475,392	9,058,598	-
	Familjare	2,649,521,775	-	-	-
	Total ne TU	3,830,388,091	24,475,392	9,058,598	-
	SHUMA	4,733,007,698	199,172,407	70,201,324	-
		4,803,209,022			

Shënim: Në strukturën e shitjes 2018 janë të përfshirë në zërin Konsum Vetjak në TU dhe Energjia e shitur për konsumin vetjak në TL

Treguesit e Bilancit 2015-2018

Treguesit e Bilancit	V 2015	V 2016	9M 2017 fakt+ 3M parashikim	V 2018
Energji Totale ne rrjetin e OSHEE Sh.a	6,494,866	6,399,716	6,495,080	6,320,012
Humbjet totale ne OSHEE Sh.a	2,035,422	1,794,451	1,689,705	1,516,803
Humbjet totale ne OSHEE Sh.a (%)	31.34%	28.04%	26.0%	24.00%
Energji e konsumuar nga kliente te kualifikuar	-			
Energji per klientet e OSHEE Sh.a te lidhur ne rrjetin e shpërndarjes	6,494,866	6,399,716	6,495,080	6,320,012
Humbjet ne OSHEE Sh.a	2,035,422	1,794,451	1,689,705	1,516,803
Humbjet ne OSHEE Sh.a (%)	31.34%	28.04%	26.0%	24.00%
Humbjet teknike ne njesite e TL	162,725	155,629	131,619	139,040
Humbjet teknike ne njesite e TL (%)	2.51%	2.43%	2.03%	2.20%
Energji per Zonat e OSHEE Sh.a	6,328,829	6,240,751	6,360,465	6,177,681
Humbjet ne Zonat e OSHEE Sh.a	1,872,696	1,638,823	1,558,086	1,377,763
Humbjet ne zonat e OSHEE Sh.a (%)	29.59%	26.26%	24.5%	22.81%
Humbjet Teknike	1,175,217	1,075,677	1,018,010	922,722
Humbjet Teknike (%)	18.09%	16.81%	15.67%	14.60%
Humbjet Jo Teknike	697,479	563,146	540,076	455,041
Humbjet Jo Teknike (%)	10.74%	8.80%	8.32%	7.20%
Energji e shitur nga rrjeti i OSHEE Sh.a	4,456,133	4,601,928	4,802,379	4,799,918
Energji e shitur per konsumin vetjak ne TL	3,311	3,336	2,996	3,291
Energji e shitur nga OSHEE Sh.a	4,459,444	4,605,265	4,805,375	4,803,209
Energji e shitur per te gjithë klientet e OSHEE Sh.a	4,459,444	4,605,265	4,805,375	4,803,209
Energji e Shitur Klienteve Familjare	2,527,646	2,587,261	2,650,716	2,649,522
Energji e shitur klienteve jo familjare	1,931,799	2,018,004	2,154,658	2,153,687

Treguesit e Bilancit Energjitik


****Shënim:** Për vitin 2017 janë marrë të dhënat faktike 9M të Bilancit të Energjisë dhe parashikimi për muajt e mbetur duke u bazuar në totalin e Energjisë së hyrë në rrjetin e OSHEE-së. Llogaritja e humbjeve Totale dhe Joteknike për vitin 2018 është bërë në bazë të parashimit të Blerjes së Energjisë për vitin 2018 nga DTE dhe parashikimit të humbjeve teknike për vitin 2018 nga DSH.

Parashikimi për vitet 2018-2021

Parashikimi i Energjisë në rrjetin e OSHEE duke filluar nga 2017 (i pritshëm) si dhe për periudhën 2018 - 2022:

	Njesia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Energjia në Rrjet	MWh	6,494,866	6,399,716	6,472,419	6,320,012	6,296,628	6,277,738	6,258,905	6,935,245
Energji e shitur	MWh	4,459,444	4,605,264	4,789,590	4,803,209	4,911,370	5,022,190	5,132,302	5,911,288
Humbjet	MWh	2,035,422	1,794,452	1,682,829	1,516,803	1,385,258	1,255,548	1,126,603	1,023,957
Humbjet	%	31.3%	28.0%	26.0%	24.5%	24.0%	20.0%	18.0%	14.8%

Në grafikun më poshtë treguesit e Bilancit Energjistik (energji e blerë, energji e shitur dhe humbjet) për 2015–2016, 2017 (parashikim) si dhe planifikimi për periudhën 2018–2022:



Ulja e humbjeve planifikuar për vitin 2018–2022 krahasuar me periudhën 2015–2016 si dhe 2017 (i pritshëm) në shitjen e e energjisë paraqitet në grafikun më poshtë:



Parashikimi i Energjisë së shitur për klientë që largohen nga OSHEE sipas nivelit të tensionit duke filluar nga viti 2019:

	Njësia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
klientët në 35 kV	MWh					57,709	57,709	57,709	58,864
klientët në 20 kV	MWh				-	376,345	376,345	376,345	383,872
zbritur klientët në 10 kV	MWh				-	-	181,887	181,887	185,524
zbritur klientët në 6 kV	MWh				-	-	-	459,014	468,194
Gjithsej	MWh					434,055	615,942	1,074,955	1,096,454

Bilanci i Energjisë për klientët që largohen nga OSHEE sipas nivelit të tensionit duke filluar nga viti 2019:

	Njësia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Energjia në Rrjet	MWh	-	-	-	-	571,125	770,036	1,311,108	1,311,108
Energji e shitur	MWh	-	-	-	-	434,055	615,942	1,074,955	1,096,454
Humbjet	MWh	-	-	-	-	137,070	154,094	236,152	214,653
Humbjet %	%	-	-	-	-	24.0%	20.0%	18.0%	16.4%

Bilanci i Energjisë për klientët e OSHEE:

	Njësia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Energjia në Rrjet	MWh	6,494,866	6,399,716	6,495,080	6,320,012	5,725,503	5,507,702	4,947,797	4,947,797
Energji e shitur	MWh	4,459,444	4,605,264	4,805,375	4,771,609	4,351,382	4,405,540	4,056,616	4,137,748
Humbjet	MWh	2,035,422	1,794,452	1,689,705	1,548,403	1,374,121	1,102,162	891,181	810,049
Humbjet %	%	31.3%	28.0%	26.0%	24.5%	24.0%	20.0%	18.0%	16.4%

2.5 Llogaritja e Shpenzimeve për blerjen e Energjisë sipas burimeve të sigurimit

Bazuar në dispozitat ligjore OSHEE sh.a ka për detyrë të sigurojë energjinë për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i furnizimit, për këtë arsye OSHEE

sh.a ka bërë planifikimin për burimet se nga do të sigurojë energjinë për furnizimin e klientëve fundorë dhe mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes si më poshtë:

Energji e Transmetuar nga OST

- Energji e Prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike Kesh sh.a.
- Energji e prodhuar nga Hec-et të lidhura në rrjetin e trasmetimit.
- Energji e prodhuar nga Hec- Ashta.
- Energjia e marrë nga linjat e interkonjksionit.

Energji e prodhuar nga hec-et e lidhura në rrjetin e shpërndarjes

Në tabelën e mëposhtme jepen të detajuara burimet dhe shpenzimet e sigurimit të energjisë bazuar në planifikimin e mësipërm për sasinë dhe çmimet përkatëse për burimet.

Parashikimi Mujor i Energjisë së Blerë (MWh)

<i>En.Për t'u Blerë 2018</i>	<i>t'u Viti</i>	<i>En. Blerë Total</i>	<i>En. Prodhimi i ASHTË-s</i>	<i>En. Podhimi i PPEE</i>	<i>En.nga prodhimi i KESH</i>	<i>En.tregu i parregulluar</i>
Janar		700,799	27,200	120,006	370,000	183,592
Shkurt		566,611	23,700	149,273	350,000	43,638
Mars		564,889	26,800	176,089	362,000	-
Prill		486,567	26,600	104,967	355,000	-
Maj		481,093	24,800	115,293	341,000	-
Qershor		459,573	17,300	60,386	311,000	70,887
Korrik		505,763	14,000	35,973	300,000	155,789
Gusht		509,929	11,200	19,434	300,000	179,295
Shtator		448,540	12,600	40,228	280,000	115,712
Tetor		467,133	16,100	91,744	280,000	79,289
Nëntor		507,880	19,000	157,880	331,000	-
Dhjetor		621,235	22,200	77,409	370,000	151,626
Total		6,320,012	241,500	1,148,682	3,950,000	979,830

<i>Çmimi 2018</i>	<i>Total</i>	<i>ASHTA</i>	<i>PPEE</i>	<i>KESH</i>	<i>Tregu</i>
Janar	4,176	8,047	7,448	1,500	6,956
Shkurt	3,869	7,970	7,448	1,500	8,807
Mars	3,632	8,032	7,448	1,500	6,515
Prill	3,100	7,967	7,448	1,500	7,426
Maj	3,235	8,186	7,448	1,500	6,172
Qershor	3,486	8,186	7,448	1,500	7,894
Korrik	4,087	8,186	7,448	1,500	8,021
Gusht	4,553	8,186	7,448	1,500	9,203
Shtator	4,328	8,186	7,448	1,500	9,786

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

<i>Tetor</i>	3,972	8,186	7,448	1,500	8,000
<i>Nëntor</i>	3,567	8,186	7,448	1,500	8,000
<i>Dhjetor</i>	4,037	8,186	7,448	1,500	8,000
Total	3,851	8,108	7,448	1,500	8,267

<i>En.Për Blerë 2018</i>	<i>t'u Viti</i>	<i>En. Blerë Total</i>	<i>En. Prodhimi i ASHTË-s</i>	<i>En. Podhimi i PPEE</i>	<i>En. nga prodhimi i KESH</i>	<i>En.tregu i parregulluar</i>
<i>Janar</i>		2,944,707,659	218,878,672	893,807,437	555,000,000	1,277,021,550
<i>Shkurt</i>		2,209,969,353	188,882,364	1,111,781,721	525,000,000	384,305,268
<i>Mars</i>		2,069,760,809	215,248,756	1,311,512,053	543,000,000	-
<i>Prill</i>		1,526,212,246	211,916,082	781,796,164	532,500,000	-
<i>Maj</i>		1,573,205,355	203,002,632	858,702,723	511,500,000	-
<i>Qershor</i>		1,617,461,594	141,610,707	449,755,104	466,500,000	559,595,783
<i>Korrik</i>		2,082,095,599	114,598,260	267,929,741	450,000,000	1,249,567,598
<i>Gusht</i>		2,336,507,539	91,678,608	144,742,228	450,000,000	1,650,086,703
<i>Shtator</i>		1,955,056,376	103,138,434	299,614,434	420,000,000	1,132,303,508
<i>Tetor</i>		1,869,413,277	131,787,999	683,309,592	420,000,000	634,315,686
<i>Nëntor</i>		1,827,917,847	155,526,210	1,175,891,637	496,500,000	-
<i>Dhjetor</i>		2,526,266,664	181,720,098	576,539,402	555,000,000	1,213,007,164
Total		24,538,574,318	1,957,988,822	8,555,382,236	5,925,000,000	8,100,203,260

Kosto për tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike sipas muajve të vitit 2018

<i>Buxheti për transmetimin e Energjisë 2018</i>	<i>Energji e transmetuar</i>	<i>Vlera në ALL</i>
<i>Janar</i>	654,972	491,229,055
<i>Shkurt</i>	499,200	374,399,855
<i>Mars</i>	480,863	360,647,392
<i>Prill</i>	415,177	311,382,832
<i>Maj</i>	409,586	307,189,673
<i>Qershor</i>	421,211	315,907,983
<i>Korrik</i>	489,293	366,969,375
<i>Gusht</i>	499,532	374,649,307
<i>Shtator</i>	431,099	323,324,018
<i>Tetor</i>	439,061	329,295,749
<i>Nëntor</i>	470,100	352,574,881
<i>Dhjetor</i>	599,095	449,321,144
Total	5,809,188	4,356,891,264

2.6 Parashikimi i kostos për disbalancat e energjisë

OSHEE sh.a sipas rregullave të tregut duke filluar që nga muaji Korrik 2016 është subjekt i disbalancave orare. Sipas rregullave të balancimit të energjisë OSHEE sh.a paguan disbalancat negative dhe të rimburohet për disbalancat pozitive.

Bazuar mbi një historik 2 vjeçar të llogaritjes së disbalancave orare negative dhe pozitive, janë llogaritur shpenzimet e disbalancave për vitin 2018, kjo duke pretenduar në zbatimin e të njëjtës metodologji të llogaritjes së disbalancave orare negative dhe pozitive edhe për vitin 2018. Në tabelën mëposhtë është vendosur sipas muajve mesatarja e sasive të disbalancave orare pozitive dhe negative llogaritur për vitin 2016 dhe 2017.

Diferenca ndërmjet vlerës në lek të disbalancave negative (mesatarisht 8,628 Lek/Mwh) me vlerën në lek të disbalancave pozitive (1,500 Lek/Mwh) na jep sasinë e shpenzimeve të OSHEE për llogari të disbalancave.

Disbalancat e energjisë

Muaji	Mesatarja e Disbalancave 2016 - 2017		Vlera në Lekë	
	Pozitive>0%	Negative>0%	Pozitive>0%	Negative>0%
Janar	19,384	(6,982)	29,076,000	53,787,045
Shkurt	39,819	(2,058)	59,728,500	20,061,460
Mars	53,011	(478)	79,516,500	3,493,633
Prill	13,871	(3,983)	20,806,500	35,595,556
Maj	12,553	(2,755)	18,829,500	18,868,202
Qershor	9,298	(5,365)	13,947,000	47,103,034
Korrik	15,729	(4,450)	23,593,500	44,842,013
Gusht	14,615	(15,621)	21,922,500	183,395,048
Shtator	12,158	(3,620)	18,237,000	42,582,757
Tetor	12,647	(22,210)	18,970,500	139,873,197
Nëntor	15,824	(5,438)	23,736,000	48,606,578
Dhjetor	8,314	(6,891)	12,471,000	50,717,827
Total	227,223	(79,851)	340,834,500	688,926,350

Duhet theksuar se metodologjia e llogaritjes së disbalancave për vitin 2018, do të ndryshojë duke sjellë ndryshime në vlerat sasi dhe lek të parashikuara. Faktorët që pritet të futen në metodologji pa pasur një historik e bëjnë të pamundur parashikimin vlerave të disbalancave të vitit 2018, veçse parashikohet që me këto rregulla presim një kosto edhe me të lartë të kostove aktuale.

2.7 Parashikim Arkëtimet gjithsej 2018

Parashikimi i vitit 2018

Për të ardhurat e pritshme nga arkëtimet totale ku përfshihen respektivisht:

- arkëtimet nga faturat e emetuara gjatë 2018.
- arkëtimet nga faturat debitore (detyrime të prapambetura).
- arkëtimet nga vlera e kamatë vonesës.
- arkëtimet nga këstet e AKM-ve.

do të arrijnë në vlerën **61,753,176,183 lekë**.

Norma e Arkëtimimit për faturë (pa përfshirë vlerën e kamatë vonesës dhe kësteve AKM), parashikohet të shkojë në masën 93% dhe parashikohet të arrijë vlerën 59,360,852,850 lekë.

Norma Total e Arkëtimimit (duke përfshirë dhe vlerën e kamatë vonesës si dhe këstet e AKM-ve), parashikohet të jetë në masën 95%, në përputhje me Planin e Rimëkëmbjes.

Specifikisht e ndarë sipas kategorive është paraqitur në tabelën e mëposhtme :

ARKËTIMET PËR FATURË

Kategoria	Total 2018
Familjarë	27,984,801,371
Privatë	24,171,170,395
Buxhetorë	2,970,649,698
Jo-Buxhetorë	4,196,523,161
Konsum vetjak	37,708,225
Total	59,360,852,850

Kamatë për faturë 561,048,333

Kamatë për AKM 617,025,071

ARKËTIMET PËR KAMATË 1,178,073,404

ARKËTIMET PËR AKM 1,214,249,929

TOTAL BUXHETI **61,753,176,183**

2.8 Strategjia e përmirësimit të shërbimit ndaj klientit

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimit të klientit OSHEE ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm që lidhen me:

- Përditësimin e të dhënave të konsumatorëve.

- Krijen e transparencës gjate procesit të leximit - rileximeve duke përfshire anomalitë, të dyshimtat.
- Riorganizimin e shërbimit të klientit duke kaluar përgjegjësinë e cilësisë së shërbimit në zonën e shërbimit, duke krijuar ambientin për vetëm “One Stop Shop” dhe reduktimin e kohës së pritjes nëpër zyrat e OSHEE'së.
- “Front desk” ku çdo konsumator mund të paraqitet në zyrat qendrore OSHEE dhe të marrë zgjidhje për kërkesë-ankesën e tij.
- Reduktimin e kohës së përgjigjes ndaj konsumatorit për ankesa kërkesa dhe lehtësimin e procedurave operacionale (dhënie fuqie autorizimi në nivele rajonale dhe agjencie).
- Riorganizimin e roleve dhe funksioneve të monitorimit dhe mbikqyrjes së marrëdhënies me klientin në qendër me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit në shërbim në gjithë territorin dhe evidentimin në kohën e duhur të çështjeve të cilësisë dhe çështjeve teknike.
- Prezantimin e teknologjive të informacionit për ndjekjen e ecurisë së kërkesave dhe ankesave dhe kontrollin e afateve të përgjigjeve dhe llojet e përgjigjeve.
- Krijimin e qendrave të trajtimit të ankesave për faturim në mënyrë që të sigurohet arritja e cilësisë së shërbimit të lexim/faturimit dhe evidentimin në kohë të çështjeve specifike.
- Pranimit të shërbimit të klientit me qëllim komunikimin e identitetit dhe organizimin e ri të kompanisë.

2.9 Projekti i Përditësimit të të Dhënave

Qëllimit i procesit është:

- Saktësimi i të dhënave të klientëve, në mënyrë që të vendoset një marrëdhënie kontraktuale e rregullt në shërbim të palëve: klientit dhe furnizuesit.
- Përditësimi/plotësimi i këtyre të dhënave, synohet që të bëhet evidentimi i saktë i të dhënave të klientit si dhe të objektit që furnizohet me energji elektrike dhe shmangia e rasteve të paqarta dhe konfuze, për shkak të pasaktësisë së këtyre të dhënave.
- Plotësimi i të dhënave të kërkuara, përfaqëson një detyrim kontraktual referuar kushteve të Kontratave Standarde të Furnizimit me Energji Elektrike, për klientët familjarë e jo familjarë, të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, sipas Vendimeve Nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të ERE-s. (apo ndryshime që mund të pësojnë këto vendime në të ardhmen).
- Identifikimi i mënyrës së ofrimit të shërbimit (sistemi i matjes) – ofron siguri mbi sasitë e furnizuara.
- Identifikimi i klientit- që ofron siguri mbi ekzistencën e llogarisë së arkëtueshme.
- Identifikimi i kategorisë së klientit ofron siguri në lidhje me të ardhurat nga shitja si rezultat i sigurisë mbi tarifimin.
- Shërbejmë në kohë për dorëzimin e faturës dhe komunikimet zyrtare.
- Shërbejmë në kohë për njoftime, detyrimet apo kujtesë për pagesë.

- Rritet efektshmëria në arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.
- Rritet besueshmëria e njohjes së të ardhurave.
- Rritet besueshmëria në gjendjet e debitorëve.

2.10 Strategjia e Përmirësimit të Cilësisë së Shërbimit

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimit të klientit, OSHEE gjatë vitit 2018 do të integrojë të gjithë data bazën aktuale të abonentëve në sistemin e ri Billing /CRM.

Objektivi kryesor është përmirësimi dhe rritja efiçencës në sektorin e shpërndarjes duke rritur efiçasitetin e sistemit dhe si rrjedhojë reduktimin e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve.

Sistemi i ri rrit efiçencën dhe menaxhimin e procesit të faturimit, ul nivelet e gabimit dhe rrit transparencën midis kompanisë dhe konsumatorit.

Një sistem efikas automatikisht do të gjenerojë konsumin e abonentit dhe më pas do të gjenerojë faturën nga këto të dhëna. Kjo redukton në masë të madhe numrin e njerëzve që kërkohen për të procesuar anomalitë gjatë faturimit, duke zvogëluar kështu mundësinë për gabime njerëzore.

Sistemi i ri do të ofrojë një platformë të avancuar teknologjike që lejon integrimin e aplikacioneve të shumta, shërbimeve dhe jep zgjidhjen mbi menaxhimin e faturave, lidhjeve të reja, shërbimit të klientit, trajtimin e pagesave si gjëndjen kontabël të klientit (mwh dhe lek).

Avantazhet e sistemit të ri:

- Lidhja e re –Abonenti mund të ndjekë statusin e kërkesës për pajisjen me kontratë të re dhe sistemi i faturimit të lexojë konsumin e matësit të ri të instaluar njëkohësisht.
- Shërbimi ndaj klientit - do të ketë procesin e zgjidhjes së një ankese/kërkese me disa hapa dhe rrjedha të përcaktuara. Ankesat ose kërkesat do të jenë të lidhura me faturimin, në lidhje me matjen ose në lidhje me furnizimin. Sistemi do të sigurojë një pamje 360 gradë të konsumit, faturimit dhe historikut të abonentit.
- Matja – do të mbledhë leximin e të gjithë matësve, fotokontrollit dhe PDA me anë të sensorëve dixhitalë të inkuorporuar në sistem.
- Faturimi – do të gjenerojë dhe printojë fatura duke përllogaritur çmimin me leximet e mbledhura. Sistemi i ri do të llogarisë faturat sipas kategorisë dhe shërbimit si dhe riaktivizime të kontratave të pezulluara apo debitorë etj.
- Pagesat - do të shqyrtojnë pagesat e bëra ndaj faturave sipas mënyrave të ndryshme të pagesës dhe kanaleve të ndryshme të pagesës. Pjesa e prerjeve dhe rilidhja do të zhvillohet sipas pagesave dhe gjëndjes kontabël të klientit.

- Prerjet dhe Rilidhja – Me anë të sistemit të ri do të rritet efikasiteti i arkëtimeve. Sistemi synon përmirësimin e shërbimit përmes një sistemi mekanik të prerjeve dhe demontimit që do të shërbejë si pengesë për debitorët.
- Management Information System (MIS) – Sistemi i ri do të ofrojë gjenerimin e raporteve direkt me një klik sipas kërkesës. Kjo është një zgjidhje për raportimin Ad hoc sipas kërkesave që lindin për Analizat & Parashikimet si dhe detajimi i të dhënave të abonentit në çdo kohë.
- Bilanci i Energjisë – kontabilizimi i energjisë, kuadrimi i balancës së energjisë në të gjitha nivelet e rrjetit, nënstacione – fidera në të gjitha nivelet e rrjetit elektrik identifikuar humbjet teknike dhe joteknike.
- Work Force Management System (WFMS) – aplikacioni për menaxhimin e fuqisë punëtore që lehtëson automatizimin e aktiviteteve më përdorim mobile ose në terren.

Gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë një sërë masash për realizimin e prerjeve dhe kontrolleve të shumta në terren. Kjo nismë është shoqëruar edhe nga policia e shtetit ku shkeljet lidhur me lidhjet e paligjshme të energjisë janë reduktuar ndjeshëm.

OSHEE gjatë vitit 2018 do të realizojë komunikimin online me abonentin, ku ky i fundit do të informohet për gjëndjen e arkëtimeve, debinë etj. me anë të kanaleve të komunikimit sms, email, pop up mesazhe etj.

III. SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE

3.1 Shpenzime për blerjen e energjisë për Shërbimin e Furnizimit Universal.

Sasia e planifikuar e energjisë që do të blihet për Shërbimin e Furnizimit Universal parashikohet të jetë 4,803 Gwh. Sasia e planifikuar të blihet nga KESH është parashikuar 3,950 GWH dhe nga HEC private parashikohet 1,390 Gwh.

OSHEE ka detyrimin të blejë të gjithë sasinë e prodhimit nga HEC private me çmim të rregulluar dhe në përlllogaritje është marrë parasysh ky detyrim. Në përlllogaritjen e shpenzimeve për energji të blerë për Shërbimin e Furnizimit Universal për vitin 2018, diferenca e energjisë së kërkuar në rrjet me sasinë e energjisë së prodhuar nga HEC private do të mbulohet nga KESH si në tabelën që vijon:

Energji e shitur	Sasia (Mwh)	Çmimi (Lekë/Kwh)	Total (000/Lekë)
Nga ASHTA	241,500	8.11	1,957,989
HEC private	1,148,682	8.50	9,763,796
KESH	3,413,027	1.50	5,119,541
TOTAL	4,803,209		16,841,325

Çmimet e blerjes së energjisë sipas prodhuesit janë parashikuar si në tabelë. Totali i shpenzimeve për energji të blerë për Shërbimin e Furnizimit Universal është parashikuar të jetë 16.84 miliard Lekë.

3.2 Shpenzime për blerjen e energjisë për Mbulimin e Humbjeve në Shpërndarje.

Llogaritja e shpenzimeve për mbulimin e humbjeve si pjesë e tarifës së Operatorit të Shpërndarjes dhe për rrjedhojë edhe të tarifës së transmetimit varet nga humbjet në rrjet dhe sasia e energjisë së shitur. Përlllogaritja e sasisë së energjisë së nevojshme në rrjet dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve është bazuar në formulat si më poshtë:

- Sasia e energjisë së nevojshme në rrjet (S) llogaritet:

$$S = P / (100\% - Ht)$$

ku:

P – Sasia e energjisë që do të shitet.

Ht – Humbjet mesatare në %

Kosto e furnizimi për gjithë sasinë e energjisë së nevojshme në rrjetin e OSHEE për vitin 2017 sipas bilancit energjistik për mbulimin e shitjeve dhe humbjeve paraqitet në tabelën më poshtë:

Energji në Rrjet	Sasia (Mwh)	Çmimi (Lekë/Kwh)	Total (000/Lekë)
KESH	3,950,000	1.500	5,925,000
HEC private	1,148,682	8.500	9,763,796
HEC Ashta	241,500	8.108	1,958,082
Tregu i lirë	979,830	8.267	8,100,255
Total	6,320,012		25,747,132

Shpenzimet për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes së energjisë për vitin 2018 llogaritur si diferencë e shpenzimeve për gjithë sasinë e energjisë në rrjet me shpenzimet për blerjen e energjisë së nevojshme për Shërbimin e Furnizimit Universal dhe pritet të jenë **8,905** milion Lekë.

IV. PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)

4.1 Përmbledhje për shpenzimet operative

Përlllogaritja e Shpenzimeve Operative për vitin 2018 u mbështet në informacionin e shpenzimeve historike sipas zërave dhe parashikimin e nevojave të vitit 2018 në një proces

pjesmarrje të gjerë të njërive sipas strukturës organizative të OSHEE i cili do të aprovohet së shpejti nga Këshilli Mbikqyrës.

Rezultatet e jashtëzakonshme të arritura gjatë periudhës 2015–2017 ishin frut i intensifikimit të punës udhëhequr nga stafi menaxhues i shoqërisë në ndryshim të metodave të mëparshme. Këto metoda intensifikuese u shoqëruan me rritje relative të shpenzimeve operative të cilat mundësuan rritjen e performancës. Kjo periudhë ishte periudha e provës mbi të cilën janë bërë analiza dhe është programuar një rritjeje e qëndrueshme financiare e shoqërisë në vitet në vazhdim. Për vitin 2018 shoqëria ka planifikuar rritje të shpenzimeve në disa nga zërat në funksion të përmirësimit të treguesve të aktivitetit kryesor të kompanisë, atij të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë.

Rritja e planifikuar lidhet kryesisht me ato zëra të cilat kanë ndikim të drejtperdrejtë në rritjen e qëndrueshme të performancës së shoqërisë sikurse janë shpenzimet për mirëmbajtje dhe konsulencë ndërsa për zëra të tjerë janë planifikuar rritje me sipas normës 3% së pritëshme të rritjes së inflacionit.

Disa nga zërat e shpenzimeve si ato për shpenzime ligjore dhe marketing do të pësojnë ulje të ndjeshme duke bërë që rritja e shpenzimeve në total të jetë vetëm 1% .

Për më tepër në tabelën krahasuese më poshtë janë vendosur treguesit e Shpenzimeve Operative për vitet 2014-2017 si dhe treguesit e prishëm për vitin 2018.

OSHEE OPEX (000 / ALL)	2014	2015	2016	2017	2018
				Parashikim	Buxhet
Shpenzime materiale dhe konsumi	338,797	293,899	310,593	356,337	408,028
Shpenzime për personelin	3,342,191	4,170,057	5,001,793	6,269,236	6,419,219
Mirëmbajtje	922,948	1,389,754	1,357,737	1,621,093	2,567,967
Penalite dhe gjopa	4,375,081	1,346,263	2,875,653	840,199	-
Mardhenie me Publikun dhe Marketing	534	94,944	78,545	109,735	5,000
Qera	290,226	334,486	412,117	447,338	465,805
Sherbime Postare dhe Komunikimi	558,735	591,543	650,873	709,627	725,870
Shpenzime Teknologjia e informacionit	27,956	36,351	73,334	259,695	279,468
Shpenzime Ligjore	253,686	94,062	145,586	242,672	7,788
Konsulencë dhe Auditim	20,142	84,480	158,409	75,303	119,000
Te tjera	598,457	709,467	1,030,300	1,046,911	1,044,339
Totali i Shpenzimeve Operative	10,728,753	9,145,306	12,094,938	11,978,149	12,042,484

Në kushtet kur ndarja e aktivitetit të shitjes me aktivitetin e shpërndarjes është akoma në proces dhe të mungesës së evidentimit të drejtpërdrejtë të kostove të ndara për Shpërndarjen dhe Shitjen e Energjisë elektrike, shpërndarja e kostove të tyre nuk mund të bëhet veçse duke përdorur koeficientë alokimi. Për këtë informacioni më i mirë i gjetur është ai i raportit ndërmjet shpenzimeve të Shpërndarjes dhe Shitjes të analizuar nga kompania CEZ Shpërndarje për aplikimin për periudhën rregullatore 2012–2014 e cila ka pasur një ndarje të qartë administrative të kompanisë në Shpërndarje dhe Shitje. Sipas këtij informacioni ndarja është bërë sipas këtij raportit Shpërndarje 79.24% dhe Shitje 20.76%:

	2014	2015	2016	2017	2018
OPEX Shpërndarje	8,501,763	7,246,995	9,584,366	9,491,819	9,542,800
OPEX Shitje	2,226,990	1,898,311	2,510,572	2,486,330	2,499,684
TOTAL OPEX	10,728,753	9,145,306	12,094,938	11,978,149	12,042,484

Analizat më poshtë përfshijnë shpenzimet operative të konsoliduara për Operatorin e Shpërndarjes dhe atë të Furnizimit në tërësi.

4.2 Shpenzime materiale dhe konsumi.

Shpenzimet për karburant dhe kancelari zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve. Shoqëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kontrollin dhe uljen e shpenzimeve në këtë zë duke tentuar normimin e shpenzimeve për aktivitetet bazë me të cilat lidhen këto shpenzime. Shpenzimet për veshje dhe vegla pune përbëjnë gjithashtu rreth 34% të totalit të shpenzimeve materiale. OSHEE ka tashmë standarte dhe normim të shpenzimeve për rrobat e dhe veglat e punës të cilat jo vetëm përmirësojnë paraqitjen dhe komunikimin me klientët por janë edhe domosdoshmëri e sigurimit teknik të punonjësve. Parashikimi për shpenzimet materiale bazohet në kostot e pritshme 2017 dhe inflacionin 2018.

4.3 Shpenzime për personelin

Ristrukturimi i skemës organizative të Shoqërisë pritet të ruajë të njëjtin nivel të shpenzimeve të personelit duke u shoqëruar më një rritje të lehtë inflative prej 2.4% në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, ndërsa numri i punonjësve do të mbetet i njëjtë më atë të vitit 2017.

4.4 Shpenzimet për Mirëmbajtje

Shpenzimet e buxhetuara për mirëmbajtje detajohen si më poshtë:

Mirëmbajtje (000/Lekë)	2,567,967
Shpenzime operative (riparime në rrjet)	1,500,000
Riparime dhe mirëmbajtje e ndërtesave	10,000
Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	126,600
Riparime dhe mirëmbajtje - të tjera	1,330
Riparim transformatorësh	300,000
Shpenzime Kolaudimi Matësash	630,038

- a) Riparimet në rrjetin shpërndarës elektrik të kompanisë zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve.

Infrastruktura e Rrjetit

	Tetor 2017
Nënstacione (No.)	175
Numri i transformatorëve në nënstatione	315
Numri i Kabinave total (No.)	25,823
Transformatorë TM /TU(No.)	26,037
Gjatësia Totale e rrjetit TM (km)	16,507.26
Linja 35 kV (km) Ajrore	1,126.6
Linja 35 kV (km) kabllore	14.1
Gjatësia e rrjetit TM kabllor 20kV(km)	1,810.30
Gjatësia e rrjetit TM ajror 20kV(km)	158.64
Gjatësia e rrjetit TM kabllor 10kV(km)	212.17
Gjatësia e rrjetit TM ajror 10kV(km)	7,560.31
Gjatësia e rrjetit TM kabllor 6kV(km)	291.51
Gjatësia e rrjetit TM ajror 6kV(km)	5,333.66
Gjatësia Totale e rrjetit TU (km)	25,380.70
Gjatësia e rrjetit TU ajror me përcjellës të xhveshur (km)	21,214.61
Gjatësia e rrjetit TU ajror me kabëll ABC(km)	2,474.75
Gjatësia e rrjetit TU kabllor nëntokësor (km)	1,691.35

- Megjithë investimet e kryera me fondet e OSHEE sha gjatë 3 viteve të fundit, ndërtime të nënstationeve të reja, rikonstruksione të atyre egzistues, investime në rrjetin shpërndarës 20kV dhe në rrjetin TU me kabëll ABC me vetëmbajtje, akoma mbetet shumë për t'u bërë pasi :

1. Rrjeti ajror dhe kabllor 6, 10kV përbën 81.2 % të rrjetit TM.
 2. Rrjeti ajror TU me përcjellës të xhveshur zë 84% të rrjetit TU.
- Struktura e vjetërsisë së pajisjeve varion nga pajisje shumë të vjetra prodhime të viteve 50 deri tek paisje nga prodhimet më të fundit. Megjithë investimet e kryera me fondet e OSHEE në rrjetin 20 kV, ndërtimin e kabinave të reja 20kV dhe rikonstruksionin e kabinave 6 kv, 10 kV, e kthimin e tyre në 20 kV OSHEE ka filluar procesin e modernizimit, por mbetet ende shumë-shumë punë për t'u bërë pasi :
1. Numri i kabinave 6 dhe 10 kV (muraturë dhe shtyllore) përbën 82% të numrit total të kabinave
 2. Numri i kabinave 20 kV (Muraturë, box dhe shtyllore) përbën 18% të numrit total të kabinave.

Asetet e vjetëruara të OSHEE kanë arritur ose tejkaluar jetëgjatësinë e përdorimit teknik. Në se nuk do të merren masat e nevojshme, për zëvendësimin e tyre, kjo mund të sjellë probleme në rritje përsa i përket operimit të rrjetit në një periudhë kohe të afërt, rritje të mëtejshme të shpeshtësisë së defekteve dhe rrezikut për siguri në punë.

Për të siguruar furnizimin me energji elektrike pa ndërprerje duke u bazuar në kërkesat e Drejtorisë TL dhe të Drejtorive, Divizioni i Shpërndarjes ka përpiluar Buxhetin e mirëmbajtjes për vitin 2018. Në këtë buxhet janë planifikuar :

- Mirëmbajtjen e N/stacioneve , një pjesë e të cilave janë tepër të amortizuara dhe kanë një ndikim të madh në treguesit e cilësisë së tranmetimit dhe në nivelin e humbjeve.
- Mirëmbajtja nga pikëpamja ndërtimore dhe infrastrukturës së shërbimit në N/stacione, gjëndja e të cilave është tepër kritike pasi provokon difekte të rënda në pajisje dhe nxjerrjen jashtë pune të tyre.
- Mirëmbajtje të linjave 35 kV për rritjen e cilësisë së transmetimit të energjisë elektrike në rrjetin shpërndarës.
- Mirëmbajtje të linjave TM 10 kV për rritjen e cilësisë së furnizimit të konsumatoreve.
- Mundësinë e kthimit të linjave më të ngarkuara dhe të gjata 6 kV në 10 kV duke përdorur strukturën ekzistuese të linjës dhe fuqizuar pjesën e përcjellësave dhe izolacionit e cila mundëson rritjen e fuqisë transmetuese.
- Mirëmbajtjen e kabinave të transformimit TM/TU duke filluar nga pjesa ndërtimore e tyre, mirëmbajtja e pajisjeve komutuese, transformatoreve dhe paneleve TU e cila rrit cilësinë e kushteve teknike të shfrytëzimit të impianteve elektrike shpërndarëse.
- Verifikimi dhe riparimi i linjave ajrore TM/TU të cilat si pasojë e ndërtimeve pa leje dhe të vendosura në distancë jashtë normave të Sigurisë së Komunitetit dhe të impianteve elektrike.
- Mirëmbajtja e linjave furnizuese të objekteve të konsumatorëve të rëndësishëm si: Hidrovore, Spitale, Ujësjellësa.

- Megjithë ndërhyrjet që janë bërë në zëvendësimin e rrjetit TU, nga ai me përcjellës të xhveshur, në rrjet TU me kabëll ABC me vetëmbajtje, është e domosdoshme të vazhdojë të bëhet mirëmbajtja e rrjetit TU egzistues i vjetëruar sepse ndikon direkt në vlerat e humbjeve të energjisë duke eliminuar vjedhjen e energjisë por edhe përmirëson dukshëm cilësinë e transmetimit të energjisë si dhe përjashton mundësinë e ndërhyrjeve të paligjëshme në rrjet.

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2018 janë planifikuar të jenë 1.5 miliard Lekë.

- b) Shpenzimet për kolaudimin e matësave si pjesë e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe si detyrim ligjor për OSHEE në vitin 2018 parashikohet të jenë rreth 630 milion Lekë.
- c) Shpenzimet për riparimin e transformatorëve bazuar në studimin e kryer tashmë kryhen tërësisht me të tretë. Për vitin 2018 këto shpenzime janë planifikuar 300 milion Lekë.
- d) Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve të OSHEE i cili gjithashtu kryhet me të tretë gjatë vitit 2018 pritet të kushtojë 126.6 milion Lekë.

4.5 Penalitete dhe Gjoha.

Shpenzimet për penalitete dhe gjoha vazhdojnë të jenë të larta edhe gjatë vitit 2017 me një parashikim prej rreth 840 milion Lekë, kryesisht si pasojë e detyrimeve ligjore që lidhen me periudha e administrimeve të viteve të mëparshme. Për vitin 2018 këto shpenzime parashikohet të jenë rreth 1 miliard Lekë megjithatë ato nuk janë llogaritur në tarifë në zbatim të metodologjisë së llogaritjes së tarifave.

4.6 Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing

Shpenzimet për marrëdhëniet me publikun dhe marketing janë planifikuar në ulje të ndjeshme në krahasim me vitet e mëparshme. Bazuar në politikat e shoqërisë për nevojën më të ulët të reklamimit edhe si pasojë e ndryshimeve strukturore të saj, shpenzimet për publicitet dhe marketing do të jenë të planifikuara vetëm 5 milion Lekë nga rreth 110 milion që parashikohet të realizohen ato të vitit 2017.

4.7 Shpenzime për Qera

Shpenzimet për qera në vitin 2018 do të kenë rritje vetëm në kufijtë e inflacionit në krahasim me shpenzimet e pritëshme 2017. Nevojat në rritje të qerave për magazine të reja do të përballohen nga ulja e tarifave ekzistuese të qerave që do të rinegociohen gjatë vitit në vazhdim.

4.8 Shërbime Postare dhe Komunikimi

Këto shpenzime lidhen kryesisht me shpërndarjen mujore të faturës për klientët dhe me tarifatat për arkëtimin e faturave nga Posta Shqiptare. Planifikimi i shpenzimeve për këto zëra u mbështet kryesisht në koston historike në realizimin dhe buxhetin 2017 si dhe rritjen e mundshme për shkak të inflacionit.

4.9 Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit

Rritja e investimeve në Teknologjinë e Informacionit e ka bërë të domosdoshme rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes së këtyre investimeve. Gjatë vitit 2018 investimet në Teknologjinë e Informacionit do të rriten prandaj edhe do të rritet mirëmbajtja e tyre e cila është parashikuar të jetë rreth 280 milion Lekë.

4.10 Shpenzime Ligjore

Shpenzimet ligjore janë ulur në mënyrë drastike në planifikimin e vitit 2018 në krahasim me vitin 2017. Shpenzimet për konsulencë ligjore me shoqëri ndërkombëtare si ajo për çështjen DIA kanë kaluar dhe nuk ka të ngjashme në parashikimin për vitin në vazhdim. Shpenzimet ligjore pritet të jenë rreth 8 milion Lekë.

4.11 Konsulencë dhe Auditim

Gjatë vitit 2018 shpenzimet e konsulencës dhe të auditimit janë planifikuar të rriten në krahasim me shpenzimet e pritëshme të vitit 2017. Ristrukturimi i shoqërisë dhe ndarja e saj organizative në Operatorin e Shpërndarjes dhe atë të Shitjes si dhe përgatitjet për operimin në kushtet e tregut të hapur të energjisë do të kërkojnë shtimin e shpenzimeve të konsulencës dhe auditimit krahas atyre normale.

4.12 Shpenzime të tjera.

Zërat kryesorë të këtij grupi shpenzimesh lidhen me sigurimin e zyrave të OSHEE ku pjesën më të madhe e zë: a) sigurimi i zyrave të arkëtimit të parave si dhe sigurimi i transportit të parave të arkëtuara, b) Shpenzimi për printimin e faturave të shitjes c) shpenzimet për primin e sigurimit etj. Këto shpenzime janë planifikuar për vitin 2018 në të njëjtat vlera të shpenzimeve të pritëshme të vitit 2017.

V. ASETET BAZË TË RREGULLUARA

5.1 Investimet (CAPEX)

Menaxhimi shumë i suksesshëm i OSHEE në periudhën 2015 – 2017 ka bërë të mundur gjetjen e fondeve për realizimin e investimeve të jashtëzakonshme në rrjetin e OSHEE të cilat janë pjesë e planit afatgjatë të investimeve në OSHEE të cilat do të synojnë në:

- Uljen e humbjeve teknike dhe jo-teknike në të gjithë rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Fuqizimin e kapaciteteve të furnizimit duke parë prioritete për zonat më problematike të vendit.
- Rritjen e koeficientëve të shfrytëzimit duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimit.

Historiku i realizimit të investimeve 2013 – 2017 (i pritshëm) si dhe planifikimi i kapitalizimit të aseteve për vitin 2018 paraqiten si më poshtë

000/Lekë

Shtesa (INVESTIM)	2013	2014	2015	2016+ Riv.	2017	2018
Të tjera AAGJ - JM	82,422	627	75,489	88,936	-	-
Sofëare	-	696	112,071	45,372	70,147	97,992
Toka	-	-	-	-	-	77,000
Përmirësimi i Tokave	-	-	-	-	6,109	32,000
Ndërtesa dhe konstruksione	4,265	94,154	94,149	643,273	700,000	200,300
Makineri dhe pajisje	297,767	1,035,495	1,027,421	6,071,846	10,694,045	12,092,979
Mjete transporti	24,694	41,854	(2,103)	118,536	-	-
Pajisje Zyre	14,947	2,726	7,562	10,482	911	-
Pajisje IT	24,369	32,581	275,998	151,611	645,054	-
TOTAL	448,465	1,208,133	1,590,587	7,130,056	12,116,267	12,500,271

Ndryshimet në vlerën bruto të aseteve në OSHEE 2012 – 2018 paraqitet në tabelën më poshtë:

000/Lekë

Përshkrimi Asete	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Të tjera AAGJ - JM	155,469	156,096	231,585	320,521	320,521	320,521
Sofëare	26,820	27,516	139,588	184,960	255,107	353,099
Toka	1,030,909	1,030,909	1,030,909	1,030,909	1,030,909	1,107,909
Përmirësimi i Tokave	755,062	755,062	755,062	755,062	761,170	793,170
Ndërtesa dhe konstruksione	2,835,935	2,930,089	3,024,238	3,667,511	4,367,511	4,567,811
Makineri dhe pajisje	30,779,976	31,815,471	32,842,892	38,914,738	49,608,784	61,701,762
Mjete transporti	389,469	431,323	429,219	547,755	547,755	547,755
Pajisje Zyre	172,121	174,847	182,410	192,892	193,803	193,803
Pajisje IT	570,592	603,174	879,171	1,030,783	1,675,837	1,675,837
TOTAL	36,716,354	37,924,487	39,515,074	46,645,131	58,761,397	71,261,668

5.2 Rivlerësimi i Aseteve

Gjatë vitit 2016 u krye studimi për rivlerësimin e asetëve nga i cili u bë rivlerësimi i tyre si në tabelën që vijon:

000/Lekë

Përshkrimi	RIVLERËSIMI		
	Rivlerësim (+)	Rivlerësim (-)	Rivlerësim Total
Të tjera AAGJ - JM	-	(3,851)	(3,851)
Sofëare	-	(5,346)	(5,346)
Toka	68,669	(48,378)	20,290
Përmirësimi i Tokave	1	(16)	(15)
Ndërtesa dhe konstruksione	498,828	(396,263)	102,564
Makineri dhe pajisje	926,987	(369,993)	556,993
Mjete transporti	13,845	(5,015)	8,829
Pajisje Zyre	647	(3,638)	(2,991)
Pajisje IT	4,487	(10,220)	(5,733)
Asete Totale	1,513,463	(842,721)	670,742

5.3 Amortizimi

Në tabelën më poshtë paraqitet Amortizimi i akumuluar ndër vite në OSHEE duke filluar nga viti 2013 si vit i kalimit të shoqërisë në administrim publik (ERE) pas periudhës 2009 – 2012 në administrim privat nga shoqëria CEZ:

000/Lekë

Amortizim i Akumuluar	2013	2014	2015	2016	2017	2018
AAGJ - Jo Materiale	61,044	85,487	103,213	141,912	168,703	191,476
Sofëare	15,542	23,305	32,668	55,053	79,800	113,446
Përmirësim i tokave	262,668	324,303	385,939	412,206	429,501	446,885
Ndërtesa dhe konstruksione	834,814	1,024,035	1,181,547	1,267,342	1,404,850	1,557,991
Makineri dhe pajisje	13,572,185	16,149,335	17,899,982	19,435,781	21,671,934	25,348,906
Mjete transporti	297,145	330,173	326,721	376,215	410,523	437,969
Pajisjet e Zyrave	92,591	105,990	118,740	130,272	142,887	153,070
Pajisje IT	509,328	549,361	590,892	656,227	780,497	1,004,332
TOTAL	15,645,316	18,591,989	20,639,702	22,475,007	25,088,696	29,254,074

Ndryshimet në vlerën neto të asetëve dhe amortizimin për vitet 2013-2017 (I pritshëm) dhe plani për 2018 paraqiten në tabelat që vijojnë për çdo vit respektiv:

VITI 2013

000/Lekë

Përshkrimi	Vlera bruto 31.12.2012	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
Të tjera AAGJ - JM	73,047	82,422	15,209	155,469	61,044	94,426
Sofëare	26,820	-	(62,320)	26,820	15,542	11,279
Toka	1,030,909	-	-	1,030,909	-	1,030,909
Përmirësimi i Tokave	755,062	-	61,636	755,062	262,668	492,394
Ndërtesa dhe konstruksione	2,831,669	4,265	188,993	2,835,935	834,814	2,001,120
Makineri dhe pajisje	30,482,210	297,767	3,069,103	30,779,976	13,572,185	17,207,791
Mjete transporti	364,775	24,694	31,431	389,469	297,145	92,325
Pajisje Zyre	157,174	14,947	92,591	172,121	92,591	79,530
Pajisje IT	546,223	24,369	80,681	570,592	509,328	61,265
TOTAL	36,267,889	448,465	3,477,325	36,716,354	15,645,316	21,071,038

VITI 2014

000/Lekë

Përshkrimi	Vlera bruto 31.12.2012	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
Të tjera AAGJ - JM	155,469	627	24,444	156,096	85,487	70,609
Sofëare	26,820	696	7,763	27,516	23,305	4,212
Toka	1,030,909	-	-	1,030,909	-	1,030,909
Përmirësimi i Tokave	755,062	-	61,636	755,062	324,303	430,758
Ndërtesa dhe konstruksione	2,835,935	94,154	189,220	2,930,089	1,024,035	1,906,054
Makineri dhe pajisje	30,779,976	1,035,495	2,577,149	31,815,471	16,149,335	15,666,136
Mjete transporti	389,469	41,854	33,028	431,323	330,173	101,150
Pajisje Zyre	172,121	2,726	13,399	174,847	105,990	68,857
Pajisje IT	570,592	32,581	40,033	603,174	549,361	53,813
TOTAL	36,716,354	1,208,133	2,946,673	37,924,487	18,591,989	19,332,498

VITI 2015

000/Lekë

Përshkrimi	Vlera bruto 31.12.2012	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
Te tjera AAGJ - JM	156,096	75,489	17,725	231,585	103,213	128,373
Sofëare	27,516	112,071	9,363	139,588	32,668	106,920
Toka	1,030,909	-	-	1,030,909	-	1,030,909
Përmirësimi i Tokave	755,062	-	61,636	755,062	385,939	369,123
Ndërtesa dhe konstruksione	2,930,089	94,149	157,512	3,024,238	1,181,547	1,842,692
Makineri dhe pajisje	31,815,471	1,027,421	1,750,647	32,842,892	17,899,982	14,942,910
Mjete transporti	431,323	(2,103)	(3,451)	429,219	326,721	102,498
Pajisje Zyre	174,847	7,562	12,750	182,410	118,740	63,670
Pajisje IT	603,174	275,998	41,531	879,171	590,892	288,280
TOTAL	37,924,487	1,590,587	2,047,713	39,515,074	20,639,702	18,875,373

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

VITI 2016

000/Lekë

Përshkrimi	Vlera bruto 31.12.2012	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
Të tjera AAGJ - JM	231,585	88,936	38,699	320,521	141,912	178,609
Sofëare	139,588	45,372	22,385	184,960	55,053	129,907
Toka	1,030,909	-	-	1,030,909	-	1,030,909
Përmirësimi i Tokave	755,062	-	26,267	755,062	412,206	342,856
Ndërtesa dhe konstruksione	3,024,238	643,273	85,795	3,667,511	1,267,342	2,400,170
Makineri dhe pajisje	32,842,892	6,071,846	1,535,799	38,914,738	19,435,781	19,478,957
Mjete transporti	429,219	118,536	49,493	547,755	376,215	171,540
Pajisje Zyre	182,410	10,482	11,532	192,892	130,272	62,620
Pajisje IT	879,171	151,611	65,335	1,030,783	656,227	374,556
TOTAL	39,515,074	7,130,056	1,835,305	46,645,131	22,475,007	24,170,124

VITI 2017

000/Lekë

Përshkrimi	Vlera bruto 31.12.2012	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
Të tjera AAGJ - JM	320,521	-	26,791	320,521	168,703	151,818
Sofëare	184,960	70,147	24,747	255,107	79,800	175,307
Toka	1,030,909	-	-	1,030,909	-	1,030,909
Përmirësimi i Tokave	755,062	6,109	17,296	761,170	429,501	331,669
Ndërtesa dhe konstruksione	3,667,511	700,000	137,508	4,367,511	1,404,850	2,962,661
Makineri dhe pajisje	38,914,738	10,694,045	2,236,152	49,608,784	21,671,934	27,936,850
Mjete transporti	547,755	-	34,308	547,755	410,523	137,232
Pajisje Zyre	192,892	911	12,615	193,803	142,887	50,916
Pajisje IT	1,030,783	645,054	124,271	1,675,837	780,497	895,340
TOTAL	46,645,131	12,116,267	2,613,689	58,761,397	25,088,696	33,672,701

VITI 2018

000/Lekë

Përshkrimi	Vlera bruto 31.12.2012	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
Të tjera AAGJ - JM	320,521	-	22,773	320,521	191,476	129,045
Sofëare	255,107	97,992	33,645	353,099	113,446	239,653
Toka	1,030,909	77,000	-	1,107,909	-	1,107,909
Përmirësimi i Tokave	761,170	32,000	17,383	793,170	446,885	346,286
Ndërtesa dhe konstruksione	4,367,511	200,300	153,141	4,567,811	1,557,991	3,009,821
Makineri dhe pajisje	49,608,784	12,092,979	3,676,972	61,701,762	25,348,906	36,352,857
Mjete transporti	547,755	-	27,446	547,755	437,969	109,786
Pajisje Zyre	193,803	-	10,183	193,803	153,070	40,733
Pajisje IT	1,675,837	-	223,835	1,675,837	1,004,332	671,505
TOTAL	58,761,397	12,500,271	4,165,378	71,261,668	29,254,074	42,007,594

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Sikundër shihet në tabelë vlera totale e amortizimit për vitin 2018 rezulton 4,135 milion Lekë. Vlera e amortizimit të akumuluar planifikohet të jetë 29,254 milion Lekë gjithsej. Vlera e aseteve dhe amortizimi sipas përlllogaritjeve në tabelat e mësipërme janë bazë për llogaritjen e Aseteve Bazë të Rregulluara (RAB).

Përlllogaritjet për vlerën e aseteve janë shënuar të veçuara për çdo vit në tabelën e përlllogaritjes së Të Ardhurës së Kërkuar si element i llogaritjes së Peshës Mesatare të Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC).

Vetëm 1/2 e vlerës së aseteve të shtuara të vitit 2018 bazuar në planin e investimeve, si rezultat i kohëzgjatjes së kapitalizimit përgjatë vitit 2018 është marrë parasysh në llogaritje.

5.4 Kapitali i punës

Vlera e kapitalit të punës për shkak të detyrimeve tejet të larta të kompanisë është negativ. Në ndryshim nga periudhat para vitit 2015 OSHEE ka detyrimin e pagesave për detyrime të prapambetura sikurse përcaktohen në Planin e Rimëkëmbjes së Sektorit Energjistik për të cilat ngurtëson një pjesë të Arkëttimeve në llogaritë bankare gjatë vitit. Mbi këtë bazë, Kapitali i punës, për efekt të tarifës është përlllogaritur sipas Metodollogjisë së Tarifës së Shpërndarjes duke pasur parasysh faktorët si vijon:

1. Vlera minimale e kapitalit të punës do të ishte sa 1/12 e shpenzimeve operative OPEX dhe bazuar në planin e shpenzimeve operative prej 12,968 milion Lekë duhet të jetë 1,080 milion Lekë.
2. Vlera minimale e ngurtësuar në llogaritë e OSHEE për shlyerje të detyrimeve ndaj CEZ është 2,819 milion Lekë. Llogaritë e ngurtësuara të OSHEE lidhen edhe me detyrime ndaj Bankës Botërore, KESH dhe OST.
3. Vlera minimale e Kapitalit të Punës në OSHEE duhet të jetë rreth 4 miliard Lekë.

Bazuar më lart në përlllogaritjet për Tarifën 2018 vlera e Kapitalit të Punës është marrë sa 1/4 e Shpenzimeve Operative ose 25%.

5.5 Përlllogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara

Sa më lart përlllogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara jepet në tabelën si më poshtë (në 000/Lekë):

Zëri (000/Lekë)	2015	2016	2017	2018
Vlera e investimeve në v. 2011	35,502,006	35,502,006	35,502,006	35,502,006
Vlera e investimeve në v. 2012	765,883	765,883	765,883	765,883
Vlera e investimeve në v. 2013	448,465	448,465	448,465	448,465
Vlera e investimeve në v. 2014	1,208,133	1,208,133	1,208,133	1,208,133
Vlera e investimeve në v. 2015	1,626,099	1,626,099	1,626,099	1,626,099
Vlera e investimeve në v. 2016	-	7,130,056	7,130,056	7,130,056
Vlera e investimeve në v. 2017	-	-	12,116,267	12,116,267
Vlera e investimeve që priten në v. 2018	-	-	-	6,250,135
minus: Amortizimi i akumuluar	(20,639,702)	(22,475,007)	(25,088,696)	(29,254,074)
vlera e RAB për 2011 pa përfshirë kapitalin e punës	18,910,884	24,205,635	33,708,213	35,792,970
Kapitali i punës 1/4	5,381,594	4,713,042	6,239,787	4,873,529
RAB	24,292,478	28,918,677	39,948,000	40,666,499

Rritja e vlerës së RAB nga viti në vit pas 2015 sipas tabelës lidhet kryesisht me nivelin e lartë të investimeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

VI. PËRLLOGARITJA E NORMËS SË INTERESIT TË BORXHIT

Përllogaritja e normës së interesit të borxhit për vitin 2018 bazuar në kostot sipas normës së interesit të kredive jepet në tabelën si më poshtë (në Lekë):

Nr	Emërtimi i Kredisë	Gjëndje 31.12.2017	Interesi në Lekë	Principali në Lekë	Kosto në lekë
1	PTDP JBIC ABA	1,349,536,952	30,174,784	149,948,550	180,123,334
2	EDCF - ALBKO Babica Project	586,548,904	17,513,856	34,857,721	52,371,578
3	Fieri Distribution project	1,044,606,307	3,099,662	45,417,666	48,517,328
4	PTDP - IDA (1) Credit 2826 Alb	-	0	0	0
5	Power Loss reduction 2677(Gov.Al)	-	0	0	0
6	PSRP Part 2 Credit No 23380	-	0	0	0
7	Italian Cooperation (ITC5) (13.02.2003)	972,332,179	3,889,329	0	3,889,329
8	Distribution project (8,6mldLIT)	-	0	0	0
9	Emergency intervention AID98	142,547,196	1,397,834	10,965,169	12,363,003
10	March 2000	1,172,920,023	2,932,300	0	2,932,300
11	Commodity Aid VII Power Supply of Korça	503,236,900	3,731,996	22,366,084	26,098,080
12	Power Supply of Southern Albania	941,144,505	6,991,446	35,514,887	42,506,333
13	Extension of Power Supply of Southern Albania	-	0	0	0

14	Bushat substation (BEI 21264)	297,134,390	13,804,343	31,309,656	45,113,998
Shuma Pagesave per Huate nga KESH		7,010,007,354.47	83,535,549	330,379,733	413,915,282
15	Detyrimi ndaj CEZ AS	2,708,854,145	104,084,144	2,708,854,145	2,867,938,289
16	Huaja nga IBRD -Min Fin	1,930,720,063	33,355,000		33,355,000
17	Huaja nga Min. Fin. 1.5 mld	1,500,000,000	3,750,000	500,000,000	503,750,000
18	Huaja nga Min. Fin.1 mld	1,000,000,000	2,500,000	1,000,000,000	1,002,500,000
Shuma e Pagesave për Hua të reja		7,139,574,208	143,689,144	4,208,854,145	4,407,543,289
Kosto totale e pagesave për 2018		14,149,581,563	227,224,693	4,539,233,878	4,821,458,571

Norma e interesit të borxhit të vjetër	1.19%
Norma e interesit të borxhit të ri	2.01%
Norma mesatare e borxhit	1.61%

Borxhi i vjetër	29.73%
Borxhi i ri	30.27%

Në tabelë është përlogaritur gjithashtu edhe raporti i pjesës që zë borxhi i vjetër në raport me borxhin e ri për të plotësuar normën prej 60% të borxhit të lejuar në krahasim me 40% të kapitalit të vet të kompanisë normuar nga manualët e ERE.

Bazuar në marrëveshjen qeveritare me kompaninë CEZ a.s. është përlogaritur edhe detyrimi ndaj kësaj të fundit së bashku me kostot e garantimit të marrëveshjes ndaj bankës Sllovaqe VUB, si dhe detyrimet ndaj kredive të Bankës Botërore dhe Ministrisë së Financave.

VII. PESHË MESATARE E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT (WACC)

Bazuar në normat e interesave për llogaritjen e koston së borxhit përlogaritja e Peshës Mesatare Të Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) për vitet 2015 – 2018 jepet në tabelën që vijon:

Zëri	2015	2016	2017	2018
Norma e interesit të borxhit të vjetër	0.83%	1.32%	1.23%	1.19%
Norma e interesit të borxhit të ri	3.80%	3.57%	3.63%	2.01%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%
Borxhi i vjetër %	32.56%	34.31%	42.96%	29.73%
Borxh i ri %	27.44%	25.69%	17.04%	30.27%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Kthim për borxhin e vjetër	0.27%	0.45%	0.53%	0.35%
Kthim për borxhin e ri	1.04%	0.92%	0.62%	0.61%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
WACC	7.89%	7.95%	7.72%	7.54%

Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet është marrë sipas përlogaritjes në Deklaratën Rregullatore.

Sikundër në tabelë Pesha Mesatare e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) për vitin 2018 do të jetë 7.54%.

VIII. TË ARDHURAT E KËRKUARA PËR SHPËRNDARËSIN E ENERGJISË

Në përmbledhje të të dhënave sa më lart përlogaritja e të Ardhurave të Kërkuara për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe tarifa jepet në tabelën që vijon:

Tarifa e Operatorit të Shpërndarjes 000/Lekë

Zëri	2015	2016	2017	2018
Shpenzime Operative	7,246,995	9,584,366	9,491,819	9,542,800
Kosto e transmetimit për humbjet	1,243,776	1,075,454	1,058,828	1,045,654
Kosto e humbjeve (sipas ERE)	13,035,606	8,192,347	14,408,503	8,905,662
Total OPEX	21,526,377	18,852,167	24,959,150	19,494,116
Vlera e investimeve në v. 2011	35,502,006	35,502,006	35,502,006	35,502,006
Vlera e investimeve në v. 2012	765,883	765,883	765,883	765,883
Vlera e investimeve në v. 2013	448,465	448,465	448,465	448,465
Vlera e investimeve në v. 2014	1,208,133	1,208,133	1,208,133	1,208,133
Vlera e investimeve në v. 2015	1,626,099	1,626,099	1,626,099	1,626,099
Vlera e investimeve në v. 2016	-	7,130,056	7,130,056	7,130,056
Vlera e investimeve në v. 2017	-	-	12,116,267	12,116,267
Vlera e investimeve që priten në v. 2018	-	-	-	6,250,135
minus: Amortizimi i akumuluar	(20,639,702)	(22,475,007)	(25,088,696)	(29,254,074)
Vlera e RAB pa përfshirë kapitalin e punës	18,910,884	24,205,635	33,708,213	35,792,970
Kapitali i punës 1/4	5,381,594	4,713,042	6,239,787	4,873,529
RAB	24,292,478	28,918,677	39,948,000	40,666,499
Norma e interesit të borxhit të vjetër	0.83%	1.32%	1.23%	1.19%
Norma e interesit të borxhit të ri	3.80%	3.57%	3.63%	2.01%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%
Borxhi i vjetër %	32.56%	34.31%	42.96%	29.73%
Borxh i ri %	27.44%	25.69%	17.04%	30.27%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.27%	0.45%	0.53%	0.35%
Kthim për borxhin e ri	1.04%	0.92%	0.62%	0.61%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
WACC	7.89%	7.95%	7.72%	7.54%
Fitimi	1,916,783	2,298,325	3,085,144	3,066,061
Amortizimi i vitit	2,079,534	2,678,027	2,400,000	2,958,096
Të ardhura nga lidhjet e reja	(645,104)	(540,865)	(654,852)	(375,677)
Të ardhurat nga energjia reaktive	(316,594)	(318,132)	(329,043)	(355,938)
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	24,560,996	22,969,522	29,460,399	24,786,658
Energji e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,459,444	4,605,265	4,789,590	4,803,209
Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/KWH	5.51	4.99	6.15	5.16

Sikundër shihet nga tabela më sipër, tarifa mesatare për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2018 sipas llogaritjeve rezulton të jetë **5.16 Lekë/Kwh** ndërsa për vitin 2017 ka qenë **6.15 Lekë/Kwh**.

8.1 Shpenzimet Operative të Operatorit të Shpërndarjes.

Ndarja e shpenzimeve operative të Operatorit të Shpërndarjes nga ato të Furnizuesit të Klientëve Fundorë është përlllogaritur sipas kritereve të përcaktuara në kapitullin V sa më lart dhe për vitin 2018 pritet të jenë 9,543 milion Lekë.

8.2 Të ardhura nga Lidhjet e Reja dhe Energjia Reaktive

Përlllogaritjet për të ardhurat nga Lidhjet e reja dhe Energjia Reaktive 2018 janë bazuar në faktin 2015–2017 dhe parashikimin 2018 .

IX. E ARDHURA E KËRKUAR PËR FURNIZUESIN UNIVERSAL

9.1 Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale janë llogaritur sipas koeficientit të shpërndarjes (alokimit) të tyre sipas studimit të vitit 2012 dhe për Furnizuesin Universal janë sa 20.76% e totalit të shpenzimeve të kompanisë. Për vitin 2018 shpenzimet operacionale janë parashikuar të jenë 2,499 milion Lekë.

9.2 Kosto e Transmetimit

Kosto e transmetimit për vitin 2018 është përlllogaritur bazuar në çmimin e pritshëm të transmetimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit 0.75 Lekë/Këh dhe në humbjen e planifikuar për këtë vit prej 24%.

9.3 Marzhi i fitimit

Marzhi i Furnizuesit Publik me Pakicë është 5% të vlerës së energjisë së shitur. Për vitin 2018 ky marzh është llogaritur 842 milion Lekë.

9.4 Kompensimi për Borxhin e Keq

Në zbatim të vendimeve të Këshillit Mbikqyrës në përmirësim të metodologjisë së llogaritjes së borxhit të keq për mosarkëtim të faturave të energjisë elektrike OSHEE angazhoi konsulentë të jashtëm të cilët kryen studimin përkatës dhe përgatitën Metodologjinë e re të përlllogaritjes së borxhit të keq dhe kryen përlllogaritjen për vitin 2016. Përlllogaritja e borxhit të keq për vitin në

vazhdim dhe planifikimi i këtij shpenzimi për vitin 2018 u kryen mbi bazën e kësaj metode dhe rezulton si në llogaritjet që vijojnë (në Lekë):

Kategoria	Faturimi	Norma e Arkëtimit	Arkëtimi	Shtesa në të arkëtueshme	Zhvierësimi (provigjon)
Familjarë	30,091,184,270	105%	31,546,264,129	(1,455,079,859)	848,501,681
Privatë	25,990,505,801	94%	24,336,636,052	1,653,869,749	(1,395,329,080)
Buxhetorë	3,194,246,987	86%	2,732,211,161	462,035,826	(362,250,879)
Jo Buxhetorë	4,512,390,496	44%	1,985,451,818	2,526,938,678	(2,260,646,351)
Total	63,788,327,553	95%	60,600,563,160	3,187,764,393	(3,169,724,630)

9.5 Përlllogaritja e tarifës për Shërbimin e Furnizuesit Universal

Përlllogaritja e tarifës për Shërbimin e Furnizuesit Universal duke marrë parasysh treguesit e veçantë të përshkruar më lart jepet në tabelën që vijon:

Zëri	2015	2016	2017	2018
Shpenzime Operative	1,898,311	2,510,572	2,486,330	2,499,684
Kosto e Energjisë së blerë për shitje	13,378,333	13,545,577	19,421,534	16,841,325
Kosto e transmetimit	2,725,012	2,760,035	3,013,587	3,311,237
Marzhi	294,323	298,003	971,077	842,066
Kompensimi i Borxhit të Keq	3,709,373	3,857,845	1,252,715	3,169,725
Kompensim për CEZ	3,051,308	2,894,742	2,787,638	2,818,842
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	25,056,659	25,866,774	29,932,882	29,467,519
Energji e shitur në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,459,444	4,605,265	4,789,590	4,803,209
Tarifa mesatare e shitjes Lekë/KWH	5.62	5.62	6.25	6.14

Vlerat në ulje të tarifës lidhen kryesisht me uljen e vlerës së kërkuar për kompensimin e humbjeve 2012–2014 e cila mban parasysh rezultatin e lartë financiar të arritur në vitin 2015.

X. PROPOZIM PËR TARIFË MESATARE TË SHITJES NGA OSHEE

Në përmbledhje të studimit të tarifës për shpërndarjen dhe shitjen sa më lart, duke pasur parasysh analizën e detajuar sipas treguesve të projektuar, OSHEE lidhur me tarifat dhe çmimet e shitjes së Energjisë Elektrike në vitin 2018 propozon sa vijon:

Në përfundim:

Meqenëse tarifa mesatare e përlllogaritur sa më lart për vitin 2018 është thuajse e njëjtë me atë të vitit 2015, duke u mbështetur në përvojën shumë pozitive të arritjeve të periudhës 2015-2017 shoqëria propozon që:

- a) *tarifa e shërbimit të shpërndarjes së Energjisë Elektrike sipas vendimit të ERE Nr147 Date 25.12.2014 dhe*
- b) *Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike si dhe çmimet e detajuara sipas vendimit të ERE Nr148 Date 25.12.2014, të mos ndryshojnë.*

XI. TARIFA E MIRËMBAJTJES NË ZERO KWH DHE TË TJERA

- a) Shoqëria ndodhet në fazë transformimi rrënjësor ku kostot e mirëmbajtjes së rrjetit janë të larta për shkak të mungesës së kryerjes së tyre për një kohë të gjatë dhe për këtë shkak mendojmë se kjo kosto e lartë nuk përfaqëson kostot normale të mirëmbajtjes prandaj edhe propozojmë që *Tarifa e Mirëmbajtjes në Zero kilovat, të mos ndryshojë.*
- b) Përlllogaritjet e mësipërme veç mundësisë së pasaktësisë që mund të përmbajnë për shkak të përdorimit të koeficientëve të shpërndarjes (alokimit) mund të kenë edhe ndryshime të mundshme si pasojë e vlerave të ndryshme nga ato të parashikuar të vërtetuara nga data e aplikimit deri në datën e marrjes së vendimit nga ERE. Me këtë rast kompania rezervon të drejtën që ti kërkojë ERE të zëvendësojë elementë të përditësuar të infomacionit.

XII. PËRLLOGARITJA E TARIFËS PËR NIVEL TENSIONI

Në kushtet e mungesës së informacionit të detajuar për të llogaritur saktësisht tarifën për nivel tensioni sikurse është përmendur edhe në paragrafin 1.3 të studimit, për përlllogaritjen e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2018 jemi bazuar në:

- a) Kërkesën për të ardhura të vitit 2018 të llogaritur për operatorin e shpërndarjes sipas përlllogaritjeve si më sipër.
- b) Koeficientëve të shpërndarjes së shpenzimeve (alokimit) që marrin parasysh sasinë e energjisë së shitur sipas strukturës, strukturën e aseteve sipas nivelit të tensionit dhe humbjet teknike të energjisë sipas nivelit të tensionit.

Koeficienti i Shpërndarjes bazuar në strukturën e shitjes dhe humbjet e vitit 2018

Niveli Tensionit	2018	%	Humbjet %
	KWH		
35 kV	57,532	1.20%	0.76%
20 kV	259,653	5.41%	1.33%
10 - 6 kV	646,577	13.46%	12.38%
I ulët 0.4 kV	3,839,447	79.94%	85.53%
Total	4,803,209		100.00%

Humbjet Teknike

Tensioni	Humbjet%
35kV	5.95%
20kV	2.31%
10-6 kV	8.64%
0.4 kV	10.05%
Total	17.90%

12.1 Përlllogaritja e shpenzimeve operative

Për shpërndarjen (alokimin) e shpenzimeve operative për nivel tensioni është përdorur pesha specifike e shitjes së energjisë elektrike sipas strukturës së shitjes. Llogaritjet jepen në tabelën e mëposhtme ku krahas të dhënave për shitjet sipas nivelit të tensionit i bashkohet edhe ponderimi me të dhënat për humbjen teknike sipas niveleve të tensionit e paraqitur në tabelë të veçantë:

12.2 Kosto e humbjeve

Për shpërndarjen e kostos së humbjeve vlerën totale të së cilës e kemi përcaktuar nga përlllogaritja e të Ardhurave të Kërkuara për operatorin e shpërndarjes, kemi përdorur koeficientin e dalë nga raporti i humbjeve për nivel tensioni si më lart me humbjet teknike.

12.3 Vlera e Aseteve Bazë të Rregulluara dhe Përlllogaritja e WACC

Për shpërndarjen e vlerës së asetëve dhe amortizimit për nivel tensioni dhe përlllogaritjes së asetëve bazë të rregulluara (RAB) është përdorur sërish raporti i shitjeve për nivel tensioni parashikuar për vitin 2018 si koeficienti alokues për nivel tensioni shpjeguar më lart. Kjo sepse vlera e asetëve për nivel tensioni nuk mund të përdorej, pasi nuk ka një studim të qartë ndarës të masës së përdorimit direkt të asetëve të tensioneve më të larta dhe përdorimit të tyre për rindarje të tensionit në tensionet më të ulta.

Pesha Mesatare e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) është thuar e pamundur të përafrohet për çdo nivel tensioni, prandaj ajo është marrë e barabartë për të gjitha nivelet e tensionit sipas përlllogaritjes për tarifën e operatorit të shpërndarjes pra 7.54%

12.4 E ardhura e kërkuar për nivel tensioni dhe tarifa

Tabela e mëposhtme përmbledh përlllogaritjen e plotë të tarifave për nivel tensioni sipas informacionit të mundësuar:

Tarifat e Operatorit të Shpërndarjes për nivel tensioni 000/Lekë

Zëri	2018	Tension i	Tension i	Tension i
		Mesëm	Mesem	Ulët
		35 kV	20-6 kV	0.4 kV
Shpenzime Operative	9,542,800	36,203	1,344,725	8,161,872
Kosto e transmetimit për humbjet	1,045,654	7,934	143,381	894,338
Kosto e humbjeve	8,905,662	33,786	1,254,943	7,616,934
Total OPEX	19,494,116	77,924	2,743,049	16,673,144
Vlera e investimeve ne v. 2011	35,502,006			
Vlera e investimeve ne v. 2012	765,883			
Vlera e investimeve ne v. 2013	448,465			
Vlera e investimeve ne v. 2014	1,208,133			
Vlera e investimeve ne v. 2015	1,626,099			
Vlera e investimeve ne v.2016	7,130,056			
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2017	12,116,267			
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2018	6,250,135			
Vlera e asetëve Gjithsej	65,047,044	779,120	12,272,549	51,995,376
minus:Amortizimi i akumuluar	(29,254,074)	(350,399)	(5,519,421)	(23,384,354)
Vlera e RAB pa përfshirë kapitalin e punës	35,792,970	428,721	6,753,127	28,611,122
Kapitali i punës	4,873,529	6,494	228,587	4,168,286
RAB	40,666,499	435,214	6,981,715	32,779,408
Norma e interesit të borxhit të vjeter	1.19%	1.19%	1.19%	1.19%
Norma e interesit të borxhit të ri	2.01%	2.01%	2.01%	2.01%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%
Borxhi i vjeter %	29.73%	29.73%	29.73%	29.73%
Borxh i ri %	30.27%	30.27%	30.27%	30.27%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.35%	0.35%	0.35%	0.35%
Kthim për borxhin e ri	0.61%	0.61%	0.61%	0.61%

Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
WACC	7.54%	7.54%	7.54%	7.54%
Fitimi	3,066,061	32,813	526,388	2,471,412
Amortizimi i vitit	2,958,096	35,431	558,110	2,364,555
Të ardhura nga lidhjet e reja	(375,677)	-	(75,379)	(300,298)
Të ardhurat nga energjia reaktive	(355,938)	(10,676)	(295,360)	(49,902)
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	24,786,658	135,492	3,456,807	21,158,911
Energji e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,803,209	57,532	906,231	3,839,447
Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/KWh	5.16	2.36	3.81	5.51

